

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SH.A.

Nr. 161 Prot.

Tiranë, më 08 . 05 .2023

Lënda: Kërkesë për emërimin e ALPEX sh.a. si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Blvd. "Bajram Curri", Rr. Viktor Eftimiu 1023, Tiranë

I nderuar Z. Ahmeti,

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a, bazuar në nenin 57 të Ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" (i ndryshuar) dhe në "Rregulloren e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar", në cilësinë e të licensuarit si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike, sipas vendimit të Bordit të ERE nr. 247, datë 29.09.2022, paraqet para Jush kërkesën për emërimin e ALPEX sh.a si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

ALPEX sh.a. njeh dhe vlerëson përmbushjen e kërkesave që rrjedhin nga aktet e cituara më lart dhe ju përcjell bashkëlidhur:

- Formatin e aplikimit, Shtojca 1.a, për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve të Nenit 4 të "Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar".
- Listën e dokumenteve të kërkuara në Shtojcën 2 të "Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar".
- Dokumentat, të dhënat dhe informacionet, në përputhje me kërkesat e nenit 3, paragrafi i parë i "Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar", do të dërgohen



pranë Jush përmes postës elektronike gjithashtu në adresën zyrtare të ERE, në formatin origjinal ose fotokopje e noterizuar.

ALPEX sh.a. mbetet i hapur për të bashkëpunuar dhe paraqitur në vijim të zhvillimit të procesit dhe deri në përmbylljen e tij çdo dokumentacion shtesë, të vlerësuar nga ju.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

ADMINISTRATOR i ALPEX sh.a.

Sokol Dishnica



Shtojca 1.a

Modeli i Formularit të Aplikimit

1. Informacione ligjore për subjektin aplikues:

- a) **Emri i subjektit aplikues:** Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a
- b) **Adresa e aplikuesit:** Rruga Liman Kaba, Rezidenca Olympic, Shkalla 3, Kati 1, Zyra p1, Tiranë, Shqipëri.

2. Informacioni i kontaktit të aplikuesit

- a) **Emri i personit të kontaktit:** Sokol Dishnica
- b) **Pozicioni i personit të kontaktit:** Administrator i ALPEX sh.a
- c) **Numri i telefonit të personit të kontaktit:** +355694023686
- d) **Adresa e email-it të personit të kontaktit:** sokol.dishnica@alpex.al
- e) **Adresa postare e personit të kontaktit:** Rruga Liman Kaba, Rezidenca Olympic, Shkalla 3, Kati 1, Zyra 1, Tiranë, Shqipëri.

3. Deklaratë nëse aplikuesi po aplikon për tu përcaktuar si NEMO për tregun e bashkuar të ditës në avancë dhe/ose atij brenda të njëjtës ditë:

Subjekti po aplikon për tu përcaktuar si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike për të funksionuar në tregun e bashkuar të ditës në avancë dhe atij brenda të njëjtës ditë.

Nëse ekziston më shumë se një zonë Ofertimi tregoni për cilën zonë ofertimi po bëhet aplikimi:

[Nuk është e aplikueshme]

4. A ka aplikuar subjekti aplikues për tu përcaktuar si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) tek një palë tjetër dhe nëse po tek cila palë/zonë ofertimi:

Subjekti nuk ka aplikuar tek një palë tjetër për tu përcaktuar si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

A është refuzuar ndonjë aplikim, nëse po për cilën palë dhe për çfarë arsye:

[Vendosni palën dhe arsyen e refuzimit]

5. Deklaratë nëse subjekti është aktiv si një monopol ligjor në një treg tjetër:

Subjekti nuk është aktiv si një monopol ligjor në një treg tjetër
Subjekti është aktiv si një monopol ligjor tek [vendosni tregun].

6. Deklaratë nëse i gjithë ose një pjesë e aplikimit është konfidenciale, arsyet përse dhe cili paragraf:

- a) **A përmban aplikimi informacion konfidencial:**
- b) **Po/Jo**
- c) **A është i gjithë apo një pjesë e aplikimit konfidencial:**

Gjithë/Një pjesë e aplikimit janë konfidenciale.

Nëse vetëm disa pjesë të aplikimit janë konfidenciale ju lutem nënvizojini ato në tekst.

d) Arsyetimi për konfidencialitetin:

[Vendosni arsyetimin për konfidencialitetin]

7. Nënshkrimi dhe deklaata për saktësinë e informacionit të paraqitur:

Unë, Sokol Dishnica, jam autorizuar të paraqes aplikimin për emërim si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe garantoj që informacioni dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e këtij aplikimi janë të vërteta, korrekte dhe përfshijnë të gjithë informacionin e nevojshëm nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a, në mënyrë që ERE të vlerësojë aplikimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a.

Z. Sokol Dishnica

Administrator i ALPEX sh.a

Tiranë

Data ____ . ____ .2023.

Lista e dokumentave të paraqitur si pjesë e këtij aplikimi:

Sipas kërkesave të Nenit 4.1.a:

1. Çertifikatën e regjistrimit;
2. Evidenca se është kuptuar mjaftueshëm legjislacioni përkatës;
3. Raporti vjetor i vitit të fundit të audituar;
4. Plani financiar që projekton të ardhurat e këtij viti dhe të vitit pasardhës që nevojiten për kryerjen e detyrave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) i cili përbehet nga:
 - a) Pasqyren e Pozicionit Financiar;
 - b) Pasqyren e fitimit dhe- humbjeve dhe të Ardhurave gjithpërfshirëse,
 - c) Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital;
 - d) Deklarim i qartë i supozimeve që janë përdorur si baze të planifikimeve;
 - e) Një analizë studimore të parashikimit të ndryshimeve të dhëna sipas supozimeve të dhëna;
 - f) Një analizë të qartë të mënyrës se si aplikuesi planifikon të financojë operimin / funksionimin duke përfshirë detajet e garancive që kanë marrë aplikuesit për të përdorur.
5. Një Plan Biznesi i cili lidhet me detyrat e tij si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) që përfshin:
 - a) Një analizë të detajuar operacionale ku përfshihen proceset kryesore të NEMO;
 - b) Një përshkrim të qartë dhe shpjegim se si do të funksionojë tregu i bashkuar i ditës në avangard dhe/ose atij brenda të njëjtes dite duke përfshirë strukturën organizative;
 - c) Strukturën organizative të përfshirë personelin dhe burimet njerezore për funksionimin dhe në mënyrë të veçantë ato që kanë lidhje me ofrimin e shërbimit IT;
 - d) Kodin e sjelljes dhe programin e pajtueshmërisë;
 - e) Synimin, natyrën, dhe qëllimin e detyrave që do të kryhen nga palët e treta dhe procedura të cilat aplikuesit synojnë të përdorin për të mundësuar ofrimin e shërbimit për palët e treta;

- f) Shpjegim i detajuar i sistemeve teknike dhe IT me qëllim për tu përdorur dhe besueshmërinë funksionale të sistemeve në fjalë;
- g) Aplikuesi do të paraqesë masat me të cilat do të identifikojë, menaxhojë dhe të shmangë konfliktin e interesit;
- h) Shpjegim i detajuar i planit se si aplikuesi ka për qëllim të bashkepunojë me Operatorët e tjerë të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit (OST) si dhe do të dokumentojë që çdo marrëveshje për këtë qëllim do të jetë në fuqi jo më vonë se 2 muaj pasi të jetë miratuar përcaktimi i Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO);
- i) Shpjegim të detajuar në lidhje me procesin e identifikimit dhe menaxhimit të rikut si dhe planifikimi të përshtatshëm i menaxhimit të rasteve emergjente.

Sipas kërkesave të Nenit 4.1.b:

- 1. Një strategji të qartë komunikimi që përfshin:
 - a) Përshkrim dhe dëshmi për vendin dhe mënyrën si pjesëmarrësit e tregut do të kenë mundësinë për të patur akses në informacion;
 - b) Proçesin e publikimit të të dhënave;
 - c) Përshkrim i planeve për rastet emergjente dhe garancia që ky informacion është në dispozicion të gjithë pjesëmarrësve të tregut.

Sipas kërkesave të Nenit 4.1.c:

- 1. Përshkrim të qartë dhe shpjegim të proçeseve të llogaritjes të cilat do të japin mundësinë aplikuesit të identifikojë dhe ndajë kostot e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO) dhe Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO);
- 2. Përshkrim të qartë dhe shpjegim të llogarive të veçanta të cilat do të përdoren për kostot e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO) dhe Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO);
- 3. Përshkrim të qartë të proçeseve të raportimit të një analizimi të qartë të të gjitha kostove të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike, përfshirë shpenzimet e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO);
- 4. Një krahasim i kostove të aplikuesit në lidhje me shembujt respektiv në Bashkimin Europian (BE) me kosto të ndara të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO).

Sipas kërkesave të Nenit 4.1.d:

- 1. Përshkrim të qartë dhe shpjegim të strukturës së aplikuesit duke përfshirë, përbërjen e bordit të tij drejtues ose organet e tjera qeverisëse, drejtorët si dhe, nëse është e mundur, interesin e tyre në treg pavarësisht lidhjes së tyre me aplikuesin;
- 2. Informacion në lidhje me biznese të tjera të mundshëm të aplikuesit përveç shërbimeve të tregut të ditës në avancë dhe brenda të njëjtes dite;
- 3. Deklaratë nëse aplikuesi është duke bashkepunuar me pale të tjera dhe nëse po çfarë aktiviteteve po ndërmerr me këto palë;
- 4. Një përmbledhje e plotë e të gjitha insitucioneve në vartësi funksionale të pjesëmarrësve të tjerë të tregut;

5. Informacion në lidhje me përbërjen dhe identitetin e zotuesve direkte dhe indirekte, pale të tjera të lidhura ligjrisht, kompanitë mëmë, dhe filialet e tyre;
6. Në rast se aksionerët, palët e tjera ligjore, kompanitë mëmë, ose filialet janë pjesëmarrës të tregut, duhet të shpjegohet sesi aplikuesi ka organizuar ndarjen e biznesit dhe eliminimin e konfliktit të interesit.

Sipas kërkesave të Nenit 4.1.e:

1. Një përshkrim dhe shpjegim të qartë të proceseve të tij të llogaritjes për çdo njërin prej aktiviteteve ligjore monopol.

Sipas kërkesave të Nenit 4.1.f:

1. Një shpjegim të detajuar të procedurave për pjesëmarrësit e tregut të bashkuar dhe që do të përdorin shërbimet e aplikuesit të cilat nuk lejojnë diskriminimin e pjesëmarrësve të tregut;
2. Rregullat e tregut të cilat do të aplikohen për të gjithë pjesëmarrësit e tregut duhet të sigurojnë që nuk do të ketë diskriminim në treg;
3. Procedurat e brendshme duhet të percaktohen me shkrim si dhe marrëveshjet funksionale, marrëveshjet kontraktore, dhe shërbimet për pjesëmarrësit e tregut të duhet mos jenë diskriminuese.

Sipas kërkesave të Nenit 4.1.g:

1. Interpretim i detajuar i programeve të trajnimit duke përfshirë:
 - a) Nese drejtuesit dhe punonjësit kanë ose do të kenë njohje të marrëveshjeve të mbikqyrjes së tregut;
 - b) Nese drejtuesit dhe punonjësit janë ose do të jenë në dijeni për çështjet e mbikqyrjes së tregut, psh. çështjet e Rregullores së Transparencës dhe Integritetit të Tregut të Energjisë Elektrike me Shumicë (**REMIT Regulation on Wholesale Energy Market Integrity and Transparency**);
 - c) Nese drejtuesit dhe punonjësit janë në dijeni të përgjegjësive të tyre për të raportuar çdo çështje të mundshme gjatë mbikqyrjes së tregut.
2. Interpretim të qartë dhe të detajuar si dhe shpjegim të skemave të monitorimit dhe proceseve që lidhen me:
 - a) grumbullimin e informacionit;
 - b) monitorimin e aktiviteteve të tregëtimit;
 - c) identifikimin e rasteve të mundshme;
 - d) vlerësimin dhe hetimin të rasteve të mundshme;
 - e) vlerësimin e përshkallëzuar të çështjeve të brendshme të mundshme duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse;
 - f) percaktimin se kush nga aplikuesi do të mbajë përgjegjësinë kryesore për keto procese dhe nëse do të krijohet një njësi e vecante për këtë çështje.

Sipas kërkesave të Nenit 4.1.h:

1. Interpretim të detajuar të mënyrës se si aplikuesit do të vlerësojnë, miratojnë dhe zbatojnë marrëveshjet për transparencë dhe konfidencialitet me pjestarët aktuale dhe të ardhshëm të tregut dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit.
2. Të paraqesë çdo marrëveshje ekzistuese që është në zbatim.

Sipas kërkesave të Nenit 4.1.i:

1. Shpjegim i detajuar i kostove të operimit dhe kërkesave të kolateralit si dhe mbajtja e tyre;
2. Përshkrim dhe shpjegim i qartë i proceseve për të vendosur se cilat garanci nevojiten për shlyerje (likuidim);
3. Vlerësim i riskut dhe analizë studimore e bërë për të treguar perballimin e riskut në vazhdim;
4. Përshkrimi i qartë dhe shpjegimi i mënyrës se si aplikuesit duhet planifikojnë të realizojnë pagesën dhe shlyerjen, përfshirë:
 - a) Rregullat që aplikohen;
 - b) Kërkesat e pjesëmarrësve,
 - c) Proceset për pagesën dhe shlyerjen e detyrimeve, përfshirë atë me Operatorët tjerë të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit.
5. Përshkrimin e qartë dhe shpjegimin e marrëveshjeve kontraktuale të nevojshme për të siguruar proceset e shlyerjes dhe likuidimit, përfshirë NEMO dhe OST e tjera dhe konfirmimin për marrëveshjet e operimit dhe ato kontraktuale të cilat lejojnë ose do të mundesojnë NEMO dhe OST e tjera që të funksionojnë në tregun e bashkuar të ditës në avancë dhe/ose atë brenda të njëjtes dite.

Sipas kërkesave të Nenit 4.1.j:

1. Përshkrim dhe shpjegim të mënyrës si do të komunikohet me Operatorët e Sistemit të Transmetimit; duke përfshirë marrëveshjet e pronësisë dhe marrëveshjet kontraktore për të vënë në punë dhe shërbim këtë pajisje;
2. Përshkrim dhe shpjegim i marrëveshjeve për rastet emergjente dhe planifikimi i menaxhimit të riskut.
3. Dokumentin e OST përkatës ku konfirmohet pranimi i përshkrimit dhe shpjegimit të kërkuar më sipër dhe konfirmimi i OST që kjo mënyrë, softëare dhe hardëare janë të pranueshme për OST.

Sipas kërkesave të Nenit 4.2:

1. Përshkrim dhe shpjegim të mënyrës si do të komunikohet me Operatorët e Sistemit të Transmetimit; duke përfshirë marrëveshjet e pronësisë dhe marrëveshjet kontraktore për të vënë në punë dhe shërbim këto pajisje;
2. Përshkrim dhe shpjegim i marrëveshjeve për rastet emergjente dhe menaxhimit të riskut.
3. Dokumentin e OST përkatës ku konfirmohet pranimi i përshkrimit dhe shpjegimit të kërkuar më sipër dhe konfirmimi që kjo mënyrë, softëare dhe hardëare janë të pranueshme për OST.



1385/
10.5.23

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SH.A.

Nr. 161/1 Prot.

Tiranë, më 08.05.2023

Lënda: Në lidhje me kërkesën e ALPEX sh.a për emërimin si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Blvd. "Bajram Curri", Rr. Viktor Eftimiu 1023, Tiranë

I nderuar Z. Ahmeti,

Në kuadër të kërkesës së Shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a, për emërimin si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), bazuar në kërkesat që rrjedhin nga "Rregullorja e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet dhe përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar", Ju parashtrojmë aktivitetin e zhvilluar nga Bursa Shqiptare të Energjisë Elektrike në cilësinë e të licensuarit si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike, sipas vendimit të Bordit të ERE nr. 247, datë 29.09.2022.

ALPEX sh.a bazuar në Vendimin e Bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022 "Për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e ALPEX – Kushtet e Përgjithshme, Përkufizimet, Procedura e Tregtimit si dhe Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes)", Vendimin e Bordit të ERE Nr. 106, datë 23.03.2023 "Mbi miratimin e disa shtesave në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 347, datë 27.12.2022" dhe në Vendimin e Bordit të ERE Nr. 127, datë 07.04.2023 "Për miratimin e Njësisë Kohore të Tregut që i përket orës 00:00 të datës 12.04.2023, si dita e fillimit të tregtimit në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike", ALPEX pasi ka përmbushur kërkesat e nevojshme për fillimin e operimit të Tregut të Ditës në Avancë të cilat janë në përputhje me paragrafin K.1.3.1 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme filloi aktivitetin e tregtimit për ditën e parë të Livrimit datë 12.04.2023.

Deri më tani, kompanitë e regjistruara si Anëtar Burse dhe që kanë përfunduar me sukses procesin e anëtarësimit, janë si vijon:

- ❖ Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a);
- ❖ Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL sh.a);
- ❖ Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU sh.a);
- ❖ Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a);
- ❖ Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a);
- ❖ Ener Trade sh.p.k; dhe
- ❖ EZ-5 Energy sh.p.k.

Gjatë muajit prill 2023 janë paraqitur aplikime të tjera të kompanive private, të cilat ALPEX po i asiston duke ofruar konsulencën përkatëse në përgatitjen e dokumentacionit të Anëtarësimit. ALPEX sh.a gjithashtu ka zbatuar procedurat e përzgjedhjes së Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit (General Clearing Member), i cili deri më tani është vetëm Raiffeisen Bank.

ALPEX në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat, si dhe Vendimet Teknike të Tregtimit dhe Vendimet Teknike të Klerimit, të nxjerra në zbatim të tyre, ka zbatuar më përpikmëri procedurat e regjistrimit të Anëtarëve të Bursës në tregun e organizuar të energjisë elektrike, duke mundur lejimin e aksesit të tyre në Sistemin Elektronik të Tregtimit në Çast (ETSS), duke marrë të gjitha hapat e nevojshme të sigurisë, duke instaluar çertifikatën e identifikimit të klientit në sistemet e ALPEX (client certificate) në pajisjet fizike të përcaktuara nga secila kompani për vendosjen e Urdërporosive nga Agjentët Tregtar të Emëruar dhe më pas të çertifikuar nga komisioni i provimit dhe i çertifikimit i ALPEX.

ALPEX në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat, si dhe Vendimet Teknike të Klerimit të nxjerra në zbatim të tyre, ka zbatuar procedurat e përzgjedhjes së Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit, i cili përmbush të gjithë kërkesat e dala nga këto akte. Në vijim, ALPEX ka mundur lejimin e aksesit të këtij Anëtarit në Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS), pas instalimit të çertifikatës së identifikimit të klientit në sistemet e ALPEX (client certificate) në pajisjet fizike të përcaktuara nga ky anëtar për kryerjen e procesit përkatës dhe më pas të çertifikuar nga komisioni i provimit dhe çertifikimit i ALPEX.

Per sa më sipër, si dhe bazuar në “Rregulloren e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet dhe përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar”, ALPEX sh.a:

- Ka dhe ka kontraktuar të gjitha burimet e nevojshme për operimin e përbashkët të tregut të ditës në avancë dhe tregut brenda së njëjtës ditë, duke përfshirë burimet financiare, teknologjinë e informacionit, infrastrukturën teknike dhe procedurat operacionale që sigurojnë ushtrimin e funksioneve të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike.
- Në përputhje me kushtet e Licensës Nr. 525, Seria O22, në cilësinë e të licensuarit në aktivitetin e operatorit të tregut të energjisë elektrike, ALPEX ka siguruar akses të hapur për informacion për të gjithë pjesëmarrësit e tregut, nëpërmjet publikimit dhe përditësimeve në faqen e tij zyrtare të internetit të të dhënave të sasive të blerjes dhe shitjes për Njësi Kohore Tregu për çdo portofol (në anonim), publikimit të Anëtarëve të Burës, Anëtarët e Përgjithshëm të Klerimit, oraret dhe datat për trajnimet dhe provimet e agjentëve tregtarë dhe agjentëve klerues, si dhe çdo të dhënë tjetër sipas parashikimeve në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat.
- ALPEX garanton trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit e tregut, pa diskriminime, i cili është vërtetuar në asistencën që ALPEX u ka dhënë të gjithë palëve të interesuara në procesin e pjesëmarrjes në Bursë.
- Sipas parashikimeve të Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 106, datë 23.03.2023, ka siguruar mbrojtjen e të dhënave të ndjeshme apo personale të çdo Anëtari në Bursë, si dhe mbrojtjen e të dhënave për të cilat merr dijëni gjatë transaksioneve, duke vendosur detyrime konfidencialiteti si për Anëtarët e Bursës ashtu dhe për ALPEX.
- ALPEX siguron shërbimet e nevojshme të likuiditetit dhe shlyerjes së detyrimeve të Anëtarëve, nëpërmjet Bankës për Shlyerje të kontraktuar nga ALPEX për këtë qëllim. Si rrjedhojë e parashikimit në paragrafin K.2.3.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme, është vendosur me anë të Vendimit të Bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022 “Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes), se për një periudhë 2-vjecare nga hyrja në fuqi e këtyre rregullave, asnjë prej anëtarëve të Bursës nuk do të pranohen të regjistrohen si Anëtar Personal Klerimi.
Kjo dispozitë do të shfuqizohet me sigurimin e likuiditetit të nevojshëm në ALPEX.
- ALPEX ka në funksion sistemet dhe rregullat e nevojshme të komunikimit dhe kordinimit me OST-në, duke përcaktuar dhe oraret e këtyre komunikimeve, të cilat janë më mirë të detajuara në Procedurën operacionale të ALPEX.
- Zbaton kërkesat për bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe atij brenda së njëjtës ditë, si dhe kërkesat për funksionet e Operatorit të Tregut të Bashkuar, nëpërmjet Ofruesit të tij të Shërbimit, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedura e Tregtimit. ALPEX sh.a në zbatim të kuadrit ligjor dhe rregullator ndjek të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mirëfunksionimin e tregut të energjisë elektrike.

Në funksion të kësaj pike, Ofruesi i Shërbimit të ALPEX sh.a ka eksperiencë të provuar për funksionimin e plotë të tregjeve të përshtatshme për operimin MRC në Bashkimin Evropian, përsa i përket përmbylljes së kërkesave të Teknologjisë së Informacionit, të procedurave të operimit dhe operacionet e bashkimit rajonal të çmimeve, shërbime të cilat ia ofron ALPEX-it.

- Zbaton çmimet maksimale dhe minimale sipas standardeve të vendeve të Bashkimit Europian, i suportuar nga algoritmi Euphemia, algoritëm i përdorur në llogaritjen e alokimit të energjisë dhe çmimeve të energjisë në Europë. Ofruesi i Shërbimit të ALPEX sh.a është anëtar i plotë i bashkimit rajonal të çmimeve (PCR-Price Coupling of Regions) dhe MRC (Multi Regional Market Coupling) dhe si i tillë ka akses në këtë algoritëm. Këto çmime janë gjithashtu të miratuara me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 106, datë 23.03.2023 “Mbi miratimin e disa shtesave në rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022”.
- Ruan anonimitetin e Anëtarëve të tij, në përputhje të plotë me Rregulloren për mbrojtjen dhe sigurinë e informacionit të brendshëm dhe konfidencial në aktivitetin e ALPEX-it, të miratuar me Vendimin Nr. 5, datë 05/10/2022 të Këshillit Mbikëqyrës të ALPEX sh.a. Në këtë kuadër ALPEX informon nëpërmjet faqes zyrtare të internetit sasitë e shitjes dhe të blerjes për Njësi Kohore Tregu (MTU) për çdo portofol në mënyrë anonime, si dhe kurbat e blerjes dhe shitjes të grupuara dhe anonime për çdo Njësi Kohore Tregu (MTU).
- Mënyra e alokimit të porosive, nxjerrja e rezultateve të sakta si dhe ndjekja e hapave të mëtejshme për saktësimin e rezultateve behët në përputhje të plotë me parashikimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike- Procedura e tregtimit.
- Informon Anëtarët e Bursës dhe pjesëmarrësit e tregut të energjisë në lidhje me rezultatet e nominimeve të tyre pa vonesa, duke i publikuar këto rezultate në faqen zyrtare të internetit çdo ditë, në formë tabele dhe grafiku.
- Vepron si kundrapalë qëndrore për klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve të pjesëmarrësve në Bursë.
- ALPEX sh.a ka të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022 “Për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e ALPEX – Kushtet e Përgjithshme, Përkufizimet, Procedura e Tregtimit si dhe Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes)”, Procedurat Alternative, pjesë e Procedurës së Tregtimit dhe do të aplikohet për segmentin e Tregut të Ankandeve të Ditës në Avancë dhe/ose segmentin e Tregut të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë, nëse ekzistojnë rrethana të cilat nuk do të lejonin operimin e Bashkimit të Tregjeve. Kjo procedurë ka parashikuar masat që do të merren në rastet kur kemi ndërprerje ose keqfunksionim të ETSS, mungesë në shkëmbimin e të dhënave që nuk mund të kryhen përmes aplikimeve të proceseve standarde brenda afateve kohore, manipulim të rezultateve të tregut, si dhe rastet apo situatat që përbëjnë Forcë Madhore. Rastet e procedurave të tregtimit emergjent në tregjet e ALPEX janë të detajuara

në Vendimin Teknik Nr. 3-T “Procedurat e tregimit emergjent në Tregjet e ALPEX”. Në rast të keqfunksionimeve teknike apo emergjencave të tjera, do të aplikohen gjithashtu parashikimet e Vendimit Teknik Nr. 4-T “Çështjet teknike mbi skedarët e bisedave”.

- Do të kordinohet me OST-të si dhe do të krijojë të gjitha marrëveshjet e nevojshme përsa i përket bashkimit të tregut të ditës në avancë dhe/ose atij brenda së njëjtës ditë.
- Në cilësinë e Agjentit të Transaksioneve, kryen rolin e entitetit me detyrën e transferimit të Pozicioneve Neto ndërmjet Kundërpalëve Qëndrore, siç është përcaktuar në Përkufizimet e rregullave të tregut të energjisë elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022 “Mbi miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX përkufizimet, procedura e tregimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes)”.
- Kryen funksionet e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO) nëpërmjet Ofruesit të tij të shërbimit dhe rrjedhimisht zbaton algoritmet, sistemet dhe procedurat që nevojiten për bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe ose bashkimin e tregu brenda së njëjtës ditë.
- Ka nënshkruar marrëveshje operationale me OST-në për komunikimet me OST-në.
- Në përputhje me kërkesat e NEMO, ALPEX do të respektojë kërkesat për komunikim me OST-të dhe NEMO-t për bashkimin e tregjeve të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, si dhe do të nënshkruajë marrëveshjet përkatëse në zbatim të këtij detyrimi.

Përsa më sipër, bazuar në “Rregulloren e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet dhe përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar”, Ju paraqesim kërkesën për emërimin e ALPEX sh.a si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), duke shoqëruar këtë shkresë përcjellëse së bashku me dokumentacionin si më poshtë vijon:


1. Formati i aplikimit, Shtojca 1.a e Rregullores, e nënshkruar nga Administratori i ALPEX sh.a, së bashku me Listën e dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit.
2. Litën e dokumenteve të kërkuara në Shtojcën 2 të “Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi të hapur për çdo kërkesë apo sqarim të mundshëm përsa më sipër.

Me respekt,

ADMINISTRATOR i ALPEX sh.a.

Sokol Dishnica



BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE – ALPEX SHA

Nr. 161/2 Prot

Tiranë, më 30.05 .2023

Lënda: Plotësim i dokumentacionit të ALPEX sh.a për emërimin si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Blvd. “Bajram Curri”, Rr. Viktor Eftimiu 1023, Tiranë

I nderuar Z. Ahmeti,

Në vijim të shkresës Nr. 161 Prot., datë 08.05.2023 “Kërkesë për emërimin e ALPEX sh.a si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe shkresës Nr. 161/1 Prot., datë 08.05.2023 “Në lidhje me kërkesën e ALPEX sh.a për emërimin si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, bashkëngjitur do të gjeni këtë shkresë sqaruese përsa i përket kriterëve teknike dhe financiare të ALPEX sh.a, të shpjeguar në përputhje me kërkesat e dispozitave të Rregullores së Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (Nemo).

Në vijim të çfarë është shpjeguar në shkresat e sipërpërmendura, të cilat janë dërguar pranë jush me rrugë postare, ALPEX sh.a në këtë listë ezauruese ka shpjeguar të gjitha kërkesat e mbetura të dispozitave të Rregullores.

Përsa i përket kriterit të përcaktuar në Nenin 4.1.a:

1. Çertifikata e regjistrimit:
E gjeni bashkëngjitur kësaj shkrese.
2. Evidenca se është kuptuar mjaftueshëm legjislacioni përkatës:
Shpjegim i dërguar me anë të shkresës Nr. 161 Prot., datë 08.05.2023.
3. Raporti vjetor i vitit të fundit i audituar;
Në lidhje me këtë pikë, bashkëngjitur kësaj shkrese gjeni Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur 31.12.2022 e cila përmban:
 - Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2022,
 - Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe Të Ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse më 31 Dhjetor 2022,

- Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital më 31 Dhjetor 2022,
 - Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare më 31 Dhjetor 2022,
 - Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022
4. Plani financiar që projektton të ardhurat e këtij viti dhe të vitit pasardhës që nevojiten për kryerjen e detyrave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO):
- Në lidhje me këtë pikë, bashkangjitur kësaj shkrese gjeni:
- Vendimin Nr. 5 dt. 24.02.2023 të Asamblesë së Përgjithshme “Për miratimin e Programit të Zhvillimit Ekonomik të ALPEX SHA për vitin 2023”
 - analizën e detajuar të këtij Programit të Zhvillimit Ekonomik duke përfshirë:
 - ❖ vlerësimet financiare, ku rolin kryesor e luajnë investimet,
 - ❖ treguesit e punës të ndarë në:

(a) Punonjës gjithsej

Numri i punonjësve të shoqërisë është 12, në përputhje me Strukturën Organizative të ALPEX SHA. Për periudhën 2023-2024 është parashikuar që numri i punonjësve të jetë në nivel më të lartë në funksion të zhvillimit të biznesit në të dy tregjet Shqipëri-Kosovë.

(b) Fondi i pagave

Në të cilin është parashikuar Fondi i pagave për stafin në Tiranë dhe Fondi i pagave për stafin në Prishtinë.

- treguesit Financiarë e ndarë në tre grupe;
 - (a) të ardhurat,
 - (b) shpenzimet dhe
 - (c) fitim (humbja) nga veprimtaria.
5. Një Plan Biznesi i cili lidhet me detyrat e tij si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) që përfshin:

a) Një analizë të detajuar operacionale ku përfshihen proceset kryesore të NEMO:

Referuar analizës së detajuar operacionale të kërkuar ku përfshihen proceset kryesore të Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO), ju bëjmë me dije se ALPEX, sa i përket organizimit dhe ndjekjes së procesit të ankandëve ditore në Tregun e Ditës në Avancë për Zonën Ofertuese të Shqipërisë, ndjek dhe zbaton me përgjegjësi një procedurë ditore operacionale të miratuar të ashtuquajtur “Procedura Operacionale”, e cila përcakton në mënyrë të detajuar të gjitha hapat, oraret, komunikimet, mënyrën e secilit proces (automatik apo manual), në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë

Elektrike – Procedura e Tregtimit, të miratuar nga ana Juaj, e cila përkon me veprimet që kryhen në Sistemin Elektronik të Tregtimit në Çast ETSS (Electronic Trading Spot System).

Për sa më sipër, Ju bejme me dije se proceset operacionale janë në përputhje me sa parashikuar në:

- ❖ Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme;
- ❖ Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Tregtimit;
- ❖ Procedura Operacionale e ALPEX.

b) Një përshkrim të qartë dhe shpjegim se si do të funksionojë tregu i bashkuar i ditës në avancë dhe/ose atij brenda të njëjtës ditë duke përfshirë strukturën organizative:

Siç edhe shprehet qartë tek Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedura e Tregtimit, Operatori i Bashkimit të Tregjeve është përgjegjës për kryerjen e Funkcionit të Operimit të Bashkimit të Tregjeve. Funkcioni i Bashkimit të Tregjeve është një shërbim i ofruar ALPEX-it nga Ofruesi i tij i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve.

Të gjitha hapat që ndiqen për këtë rast për Tregun e Ditës në Avancë dhe atë Brenda së Njëjtës Ditë janë të qartësuara në këto rregulla të miratuara nga Ju dhe më konkretisht përshkruhen në seksionin B.1.10 “Operimi i Bashkimit të Tregjeve për Tregun e Ditës në Avancë” dhe në seksionin C.1.6 “Operimi i Bashkimit të Tregjeve për Tregun Brenda së Njëjtës Ditë”.

Gjithashtu, si në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedura e Tregtimit ashtu edhe në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Termat e Përgjithshme është shtjelluar mënyra sesi funksionon Tregu i Bashkuar i Ditës në Avancë dhe Tregu Brenda së Njëjtës Ditë.

c) Strukturën organizative përfshirë personelin dhe burimet njerëzore për funksionimin dhe në mënyrë të veçantë ato që kanë lidhje me ofrimin e shërbimit IT:

Referuar Strukturës Organizative të kërkuar, përfshirë personelin dhe burimet njerëzore për funksionimin dhe në mënyrë të veçantë ato që kanë lidhje me ofrimin e shërbimit IT, Ju bëjmë me dije se:

Në Planin Strategjik të Veprimtarisë së ALPEX sh.a., të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin Nr. 7 datë 24.02.2021 dhe nga Asambleja e Përgjithshme me vendimin Nr. 3 datë 25.02.2021 ishte parashikuar që kur ALPEX të jetë operacional organograma do të përshtatej sipas kërkesave të nevojshme në lidhje me operimin dhe

aktivitetin e saj në tërësi. Numri i punonjësve i parashikuar në këtë Plan Strategjik ishte 17 punonjës në total.

Në vijim dhe në përputhje me Termat e Referencës dhe kontratës me objekt “Platforma Elektronike e Tregimit për Tregun e Ditës në Avancë dhe atë Brenda së njëjtës Ditë, Infrastruktura dhe Shërbimet e Kërkuara për Operimin e Tregut të Organizuar në Shqipëri dhe Kosovë”, të nënshkruar midis ALPEX sh.a (Autoritet Kontraktues) dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) "Hellenic Energy Exchange S.A.", "Enex Clearing House S.A." dhe “Hellenic Exchanges - Athens Stock Exchange S.A., parashikohej që Ofruesi i Shërbimit përveçse do të zhvillonte Platformat e Tregimit, Klerimit dhe Shlyerjes dhe Menaxhimit të Riskut duhet ti ofronte ALPEX-it këshillim në lidhje me strukturimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, ku përfshihen rekomandime për planin e rekrutimit dhe strukturën organizative përpara se shoqëria të fillojë tregtimin, gjë për të cilën Ofruesi i Shërbimit ka dhënë tashmë sugjerimet e nevojshme.

Për funksionimin sa më të mirë të shoqërisë, si edhe duke marrë parasysh sugjerimet dhe eksperiencën e Ofruesit të Shërbimit, ALPEX është duke rishikuar strukturën e saj organizative me qëllim të harmonizimit të saj në funksion të aktivitetit për të cilin është krijuar si shoqëri dhe detyrimeve që rrjedhin nga licenca Nr. 525, datë 29.09.2022 “Për veprimtarinë e Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike”, të lëshuar nga ana Juaj (ERE) si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike, e cila pritet të propozohet pranë administratorit të ALPEX, në zbatim të Urdhrit të Brendshëm Nr. 19, Nr. 156 Prot., datë 04.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e strukturës organizative të ALPEX sh.a”, sipas afateve të përcaktuara.

Grupi i punës i ngritur për këtë qëllim është duke finalizuar propozimet me disa ndryshime të strukturës organizative që vijnë si rrjedhojë e rritjes së kapacitetit të ALPEX në kuadër të lançimit të Tregut të Ditës në Avancë në Shqipëri, si dhe nga kërkesat e Bashkimit të Tregjeve të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, duke paraqitur gjithashtu argumentet mbështetës për çdo propozim përkatës.

Në vijim pritet që propozimi i grupit të punës të paraqitet për miratim pranë Organit Vendimmarrës, pra tek Këshilli Mbikëqyrës i ALPEX sh.a.

Sa i përket burimeve njerëzore për ofrimin e shërbimit IT, Ju bëjmë me dije se është menduar që ky shërbim të mundësohet nga jashtë (outsorce), nëpërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a), aksionar i ALPEX sh.a, kjo referuar eksperiencës dhe ekspertizës që OST sh.a ka në shërbimet e Infrastrukturës së Teknologjisë në fushën e energjisë elektrike, pjesë e gamës së sistemeve që ky operator administron, menaxhon dhe mirëmban.

Për këtë qëllim midis Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a) dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sha (ALPEX sh.a), pritet të nënshkruhet një marrëveshje për këtë qëllim.

d) Kodin e sjelljes dhe programin e pajtueshmërisë:

Referuar Kodit të Sjelljes dhe Programit të Pajtueshmërisë në ALPEX, ju bëjmë me dije se Këshilli Mbikëqyrës i ALPEX sh.a, nëpërmjet Vendimit Nr. 10, datë 03.06.2021 “Për miratimin e Kodit të Etikës së ALPEX sh.a”, ka miratuar Kodin e Etikës së ALPEX sh.a, si një dokument mjaft të rëndësishëm, i cili ka si qëllim kryesor të identifikojë disa prej sjelljeve kryesore që priten nga punonjësit e shoqërisë, përfshi drejtuesit e çdo niveli, si dhe të shpjegojë vlerat thelbësore që duhet të frymëzojnë punën e të gjithë atyre që operojnë në interes të shoqërisë, brenda dhe jashtë saj, edhe me bashkëpunëtorët e saj.

Kodi i Etikës vlen për të gjithë, drejtuesit dhe punonjësit e shoqërisë dhe njësitë vartëse, të cilët përveç nëse është specifikuar ndryshe, do të referohen së bashku si punonjës. Ky Kod Etike ka për qëllim që të plotësojë, dhe jo të zëvendësojë politikatat dhe procedurat e tjera të shoqërisë, dhe ai do të zbatohet duke marrë në konsideratë këto politika dhe procedura.

Shoqëria është e përkushtuar që në vazhdimësi të rishikojë dhe përditësojë politikatat dhe procedurat organizative. Prandaj Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë rezervon të drejtën që të përmirësojë, të ndryshojë ose të shfuqizojë këtë Kod Etike në çfarëdo kohe dhe për çfarëdo arsye, duke respektuar ligjin e aplikueshëm.

Sa i përket Pajtueshmërisë së punonjësve të shoqërisë me këtë Kod Etike të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i ALPEX sh.a, Ju bëjmë me dije se çdo punonjës i punësuar në kompani, e lexon, njihet dhe pajtohet me këtë Kod Etike, duke e vërtetuar këtë pajtueshmëri me nënshkrim individual, i cili disponohet në dosjen përkatëse të secilit punonjës pranë ALPEX.

e) Synimin, natyrën, dhe qëllimin e caktimit të detyrave që do të kryhen nga palët e treta dhe procedura të cilat aplikuesit synojnë të përdorin për të mundur ofrimin e shërbimit për palët e treta:

Operatori i Tregut – Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX SH.A është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe funksionimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike nëpërmjet platformës së tregtimit elektronik, platformës elektronike të kleringut dhe shlyerjes financiare për Tregun Ditë në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë, si dhe Tregjet e Vazhdueshme Brenda së Njëjtës Ditë, ndërmjet anëtarëve të Bursës, në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike dhe:

- ❖ Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme;
- ❖ Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Tregtimit;
- ❖ Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Klerimit.

Rregullat dhe Procedurat e mësipërme janë miratuar nga ERE dhe ZRrE më datë 27.12.2022.

Referuar parashikimeve të Marrëveshjes së nënshkruar midis ALPEX sh.a (Autoritet Kontraktor) dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) "Hellenic Energy Exchange S.A.", "Enex Clearing House S.A." dhe "Hellenic Exchanges - Athens Stock Exchange S.A (Ofruesi i Shërbimit), është parashikuar që Ofruesi i Shërbimit do të ofrojë platformat e tregtimit, platformat e klerimit dhe shlyerjes ALPEX-it, me qëllim organizimin e tregut të ditës në avancë dhe atij brenda së njëjtës ditë, si dhe bashkimin e tregjeve të ditës në avancë me zonën e ofertimit të Kosovës.

Për sa më sipër, Ju bëjmë me dije se proceset e parashikuara në sa më sipër përmendur prej datës 11 Prill 2023 janë duke u implementuar nga:

- Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX SH.A
- Anëtarët e Bursës;
- Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit (Banka për Shlyerje).

Nëpërmjet platformave/sistemeve të sipërcituara duke garantuar operacionet e tregtimit dhe klerimit pa probleme.

f) Shpjegim i detajuar i sistemeve teknike dhe IT me qëllim për tu përdorur dhe besueshmërinë funksionale të sistemeve në fjalë;

Referuar shpjegimit të detajuar të kërkuar në lidhje me sistemet teknike dhe IT me qëllim për tu përdorur dhe besueshmërinë funksionale të sistemeve në fjalë, ju bëjmë me dije se ALPEX-i në vetvete ka mekanizmat, sistemet dhe procedurat për garantimin e operimit pa probleme, normal dhe të sigurtë duke ndjekur praktikat më të mira të Tregut në këtë fushë.

Për garantimin e operimit të sigurtë dhe pa probleme ALPEX-i ka parashikuar këto në seksionin F.2.1.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Termat e Përgjithshme, të cilat janë të miratuara nga ana Juaj, ku është shprehur që Sistemi Elektronik i Tregtimit në Çast ETSS (Electronic Trading Spot System) ka një tjetër sistem në gatishmëri, i cili në vetvete është sistem i pavarur elektronik dhe që do të aktivizohet në rast të mosfunksionimit të sistemit kryesor. Njëkohësisht, për garantimin e sigurtë dhe pa probleme të Tregtimit, në seksionin G.3, Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër, të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Tregtimit, e miratuar

nga ana Juaj, është e parashikuar qartë se çfarë ndodh në rastet kur rrjeti nuk punon ose në rast të ndonjë problemi tjetër teknik ose funksional që pengon një Anëtar të Bursës të bëjë vendosi urdhërporosi në ETSS.

Gjithashtu, sa i përket garantimit të sigurisë dhe përputhshmërisë së ndërlidhjes së rrjetit të një Anëtari të Bursës me sistemin ETSS që përdor ALPEX janë parashikuar edhe detaje të tjera të hollësishme për të ndihmuar një Anëtar të Bursës për këtë qëllim. Këto të dhëna janë të parashikuara në seksionin G.1.2, Aksesi teknik, të Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Tregtimit, e miratuar nga ERE. Për çështje sigurie, ALPEX ju lejon akses për përdorim në sistemet e veta vetëm përdoruesve të autorizuar siç është parashikuar në seksionin F.2.3 të Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Termat e Përgjithshme, e miratuar nga ERE.

Për sa më sipër përmendur, procedura “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër”, është parashikuar dhe detajuar në Vendimin Teknik Nr. 2 – T “Procedurat e tregtimit emergjent në Tregjet e ALPEX”, objekti i të cilit është të përcaktojë mekanizmat dhe procedurat alternative të tregtimit në rast të keq funksionimit të Sistemit të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) ose emergjencave të tjera, me qëllim ruajtjen e funksionimit të duhur të Tregjeve të ALPEX-it dhe mbrojtjen e interesave të Anëtarëve të Bursës.

Në këtë vendim janë parashikuar veprimet që ndërmerren në rastet përjashtimore nga tregtimi i zakonshëm, Klerimi dhe Shlyerja ose emergjenca të tjera. Në rast të keq funksionimeve të rrjetit, keq funksionimeve të sistemit ETSS, keq funksionimeve të komunikimit të Sistemit të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) me Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS), apo keq funksionimeve në sistemet periferike, ALPEX do të garantojë se:

- ❖ është zbuluar keq funksionimi dhe sistemi i menaxhimit për këtë problem do të aktivizohet;
- ❖ janë ndërmarrë veprime korigjuese, dhe
- ❖ veprimet për zgjidhjen e keq funksionimit regjistrohen, duke informuar Anëtarët e Bursës me çdo mjet të përshtatshëm për problemin.

Procedura për mbështetjen e Tregtimit të Anëtarëve të Bursës parashikon se në rast të keq funksionimeve teknike të sistemeve të Anëtarëve të Bursës ose emergjencave të tjera, ALPEX-i u mundëson Anëtarëve të Bursës akses në ETSS nëpërmjet shërbimit “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër” të ALPEX siç përshkruhet në seksionin G.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurat e Tregtimit.

Në këtë rast, Agjentët Tregtar të Certifikuar, të cilët tashmë janë të regjistruar në bazën e të dhënave të Anëtarëve të Bursës, mund të aplikojnë nëpërmjet një linje telefonike të regjistruar ose nëpërmjet Mjetit Elektronik të Emëruar (i cili do të sigurohet nga

ALPEX-i) për ndihmën e ALPEX-it, për dorëzimin e një Urdhërporosie të re në ETSS, për modifikimin ose për anulimin e një urdhërporosie të dorëzuar, duke plotësuar të gjitha fushat e detyrueshme të Urdhërporosisë me ndihmën e ALPEX-it dhe në çdo rast 20 (njëzetë) minuta përpara Kohës përkatëse të Mbylljes së Portës. ALPEX-i do të kërkojë gjithashtu konfirmimin e Urdhërporosisë, nëpërmjet një formulari të përshtatshëm për regjistrimin e fushave të detyrueshme të Llojeve të Urdhërporosive, të ofruara nga ALPEX-i. Anëtar i Bursës nuk mund të pretendojë se Urdhërporositë janë dorëzuar në ETSS nëse nuk kanë marrë një konfirmim me shkrim nga ALPEX-i. Për më tepër, ALPEX nuk do të garantojë disponueshmërinë e numrit të mjaftueshëm të linjave telefonike. Shërbimi “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër” mund të përdoret vetëm për D-1 (orët e punës), në kuadër të Ditës së Livrimit.

ALPEX nuk mban asnjë përgjegjësi për dorëzimin me vonesë të Urdhërporosive gjatë përdorimit të shërbimit “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër”. Nëse paraqitet një numër i madh kërkesash, ALPEX-i do të dorëzojë Urdhërporositë duke u bazuar në parimin e përparësisë kohore, përveç rasteve kur ka arsye për ruajtjen e funksionimit të mirë të tregut ose parandalimin e rreziqeve për Klerimin e Transaksioneve, që justifikojnë shmangien nga parimi i sipërpërmendur. Në çdo rast, plotësimi i kërkesës është parakusht për ofrimin e shërbimit.

Detajet teknike të regjistrimit të bisedave telefonike apo ruajtjes së shkëmbimit të të dhënave për shërbimin “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër”, paraqiten si më poshtë:

- ❖ ALPEX do të regjistrojë bisedat telefonike apo do të ruajë shkëmbimet e të dhënave që lidhen me dorëzimin e Urdhërporosive të reja në ETSS, modifikimin ose anulimin e një Urdhërporosie të dorëzuar, duke marrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë.
- ❖ ALPEX do të verifikojë identitetin e telefonuesit përpara se të kryejë shërbimin “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër”.
- ❖ Numri/at e telefonit për komunikimet me ALPEX-in do të postohen në faqen zyrtare të ueb-it të ALPEX www.alpex.al.
- ❖ Nuk lejohet kryerja e shërbimit “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër” nga numra të tjerë të telefonit të Agjentëve Tregtar të Certifikuar, përveç atyre të dhëna në Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë.

Për të garantuar sigurinë për lidhjen e përdoruesit me sistemet që përdor ALPEX, përveç sa është përmendur më lart, ALPEX, në bashkëpunim edhe me Ofruesin e Shërbimit përveç detajeve të tjera teknike, për lidhje të sigurtë dhe të qëndrueshme me përdoruesin e Anëtarit të Bursës, ALPEX lëshon edhe “Client Certificates” nëpërmjet ATHEX, të cilat instalohen në pajisjet e punës që do të përdorë Agjenti i Certifikuar nga ALPEX, si dhe i garanton atij një mënyrë të lehtë, të besueshme, të fshehtë dhe krejtësisht të sigurtë për të ndryshuar kredencialet sipas dëshirës së përdoruesit. Instalimi në pajisje i “Client Certificates” dhe ndryshimi i kredencialeve bëhet

nëpërmjet dhe në zbatim të një manuali të ashtuquajtur “Installation instructions for ETSS Web-Trader PKI Client Certificate”, të përgatitur nga Ofruesi i Shërbimit, ku përshkruhen gjithë hapat që duhet të ndiqen.

Për sistemin EMCS, ALPEX ka në dispozicion si “Production Environment” ashtu edhe “User Acceptance Test” dhe të dyja këto sisteme janë të pa-varura nga njëra tjetra dhe janë komplementare të njëra tjetrës në rast të shfaqjes së ndonjë problemi me “Production Environment”, atëherë në mënyrë automatike do të hyjë në përdorim sistemi tjetër që është plotësisht në gatishmëri dhe që është i testuar për këtë gjë në shumë teste të kryera ndërmjet ALPEX, Bankës për Shlyerje dhe Ofruesit të Shërbimit apo edhe improvizimeve të shpeshta që kemi kryer ndërmjet Ofruesit të Shërbimit dhe një Anëtar Personal Klerimit për këtë qëllim. Sistemet në gatishmëri si nga ana e Ofruesit të Shërbimit ashtu edhe momentalisht nga ana e Bankës për Shlyerje janë të stacionuara në vende të posaçme dhe jo në të njëjtën Data-Center ku ndodhen mjediset kryesore që janë në përdorim. Këto ambiente ku janë të vendosura sistemet në gatishmëri lidhen me sistemet qendrore me Fibër Optike me disa lidhje dhe rrugëkalimi totalisht të ndryshme nga ajo qendrore. Lidhja e EMCS si e Production, ashtu edhe e sistemeve në gatishmëri përdorin disa certifikata sigurie të lëshuara nga ALPEX dhe Ofruesi i Shërbimit të cilat instalohen në sistemet qendrore respektive për të garantuar qëndrueshmëri dhe siguri shumë të lartë.

Njëkohësisht, çdo përdorues i sistemit EMCS përdor një “Client Certificate” që e instalon në pajisjet e tij të punës që do të përdorë çdo Agjent Klerues i certifikuar nga ALPEX si dhe garanton atij një mënyrë të lehtë, të besueshme, të fshehtë dhe krejtësisht të sigurtë për të ndryshuar kredencialet sipas dëshirës së përdoruesit. Instalimi në pajisje i “Client Certificates” dhe ndryshimi i kredencialeve bëhet nëpërmjet dhe në zbatim të një manuali të ashtuquajtur “Installation instructions for ETSS Web-Trader PKI Client Certificate”, të përgatitur nga Ofruesi i Shërbimit, ku përshkruhen gjithë hapat që duhet të ndiqen.

Në rast të ndonjë problematike, ALPEX e ka parashikuar këtë gjë për mënyrën e veprimit në seksionin D.3.8.2 të Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes.

Gjithashtu, për realizimin e punëve të përditshme, ALPEX, përveç lidhjes me Anëtarët e Bursës dhe Bankës për Shlyerje apo Agjentëve të Çertifikuar të Klerimit, siguron edhe lidhjen me sistemin e menaxhimit të tregut të OST-ve, Shqipëri dhe Kosovë. Kjo lidhje është e siguruar për shkëmbimin e informacioneve të përditshme siç parashikohet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Termat e Përgjithshme apo Procedura e Tregtimit, të miratuara nga ana Juaj.

Edhe kjo lidhje është e realizuar si me sistemin kryesor të ALPEX ashtu edhe me sistemin në gatishmëri dhe kjo lidhje është e siguruar nëpërmjet certifikatave të sigurisë të lëshuara nga të dy sistemet për rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë ndërmjet palëve e për të eliminuar ndërhyrjet nga jashtë. Edhe nga ana e OST-ve janë marre masat e duhura për garantimin e lidhjes në sistemin qendror edhe atë në gatishmëri. Për këtë qëllim janë realizuar shumë teste për të garantuar qëndrueshmërinë e lidhjeve dhe garantimin e sigurisë së tyre. Si lidhjet e sistemeve qendrore me njëra tjetrën ashtu edhe ato në gatishmëri përveç certifikatave të sigurisë, janë kryer duke realizuar lidhjen ndërmjet tyre site-to-site VPN high availability connectivity.

Pra, ALPEX, i garanton të gjithë përdoruesve të sistemeve të ALPEX, lidhje të qëndrueshme dhe të sigurtë, si dhe procedura alternative për mbështetjen e të gjithë Anëtarëve të Bursës apo përdoruesve të sistemeve të saj.

Përveç sa më sipër, ju bëjmë me dije se platformat/sistemet e përdorura nga ALPEX, në të cilat kryhet tregtimi apo klerimi, janë sisteme, të dhënat e të cilave e kanë qendrën/bazën në sistemet e veçanta të serverëve në ATHEX, në Athinë, dhe këto të dhëna mund të auditohen nga ERE sa herë që është e nevojshme.

g) Aplikuesi do të paraqesë masat me të cilat do të identifikojë, menaxhojë dhe të shmangë konfliktin e interesit:

Referuar masave me të cilat ALPEX do të identifikojë, menaxhojë dhe të shmangë konfliktin e interesit, ju bëjmë me dije se Këshilli Mbikëqyrës i ALPEX sh.a, nëpërmjet Vendimit Nr. 10, datë 03.06.2021 “Për miratimin e Kodit të Etikës së ALPEX sh.a”, ka miratuar Kodin e Etikës së ALPEX sh.a, si një dokument mjaft të rëndësishëm, i cili ka si qëllim kryesor të identifikojë disa prej sjelljeve kryesore që priten nga punonjësit e shoqërisë, përfshi drejtuesit e çdo niveli, si dhe të shpjegojë vlerat thelbësore që duhet të frymëzojnë punën e të gjithë atyre që operojnë në interes të shoqërisë, brenda dhe jashtë saj. Respektimi i ligjit, siç është shkruar por edhe në frymën e tij, është themeli mbi të cilin janë ndërtuar standardet etike të shoqërisë. Të gjithë punonjësit duhet të përpiqen në mirëbesim që t’u përmbahen dhe të respektojnë aktet ligjore, nënligjore, rregullat, rregulloret, urdhrat dhe vendimet rregullatore që janë të zbatueshme gjatë aktivitetit të shoqërisë. Ndër parimet kryesore të kodit të etikës janë dhe vlejnjë të përmenden si:

- Korrektësia gjatë kryerjes së aktiviteteve;
- **Njohuria dhe respektimi i ligjeve;**
- **Marrëdhëniet me palët e treta dhe komunikimi i jashtëm;**
- **Detyrimet ndaj autoriteteve shtetërore dhe rregullatore;**
- Konkurrenca e ndershme;

- **Mbrojtja e informacionit tregtar konfidencial;**
- **Konflikti i interesit**

Është rreptësisht e ndaluar që të përdoret funksioni që mbahet brenda shoqërisë për të krijuar përfitime ose përparësi të çfarëdo lloji, për vetveten apo anëtarët e familjes. Prandaj gjatë kryerjes së detyrave funksionale, punonjësi kërkohet që të veproj në përputhje me standardet më të larta etike, pa ndikimin e interesave personale në aftësinë për të vlerësuar dhe marrë vendime të paanshme. Për këtë arsye, punonjësi duhet të shmang situata në të cilat mund të ketë qoftë edhe dyshim të konfliktit të interesit, në dukje e thjeshtë por që mund të dëmtojë imazhin e Shoqërisë, të ndikojë keq në marrëdhëniet ndërmjet kolegëve dhe rrezikon besimin që pjesëmarrësit e tregut dhe autoritetet kanë për shoqërinë. Prandaj të gjithë duhet të jenë tërësisht të vëmendshëm dhe të jenë në dijeni për praninë e konflikteve, duke sqaruar çfarëdo dyshimi me drejtuesit dhe/ose eprorin e vet të drejtpërdrejtë si dhe me Administratorin e shoqërisë. Nëse punonjësi e gjen vetën në një situatë të konfliktit të interesit, qoftë edhe konflikt i mundshëm të interesit, ai duhet të njoftojë menjëherë drejtuesin dhe/ose eprorin e vet dhe, në fund, Administratorin e shoqërisë, të cilët do të ndërmarrin hapat e nevojshëm, duke respektuar rolet e secilit në mënyrë që të mbrohet shoqëria. Po ashtu, kushdo që gjatë kryerjes së detyrave të veta funksionale në shoqëri, vihet në dijeni për konflikt të interesit dhe/ose situata me palë të treta që mund të përbëjnë, qoftë edhe potencialisht, konflikt të interesit, nga ta kërkohet që të informojnë drejtuesin dhe/ose eprorin e vet të drejtpërdrejtë dhe Administratorin e shoqërisë.

Gjithashtu, kjo është e parashikuar edhe në kontratat individuale të të gjithë stafit të ALPEX.

Për sa më sipër, bashkëngjitur do të gjeni një kopje të Kodit të Etikës së ALPEX sh.a.

- h) Shpjegim i detajuar i planit se si aplikuesi ka për qëllim të bashkëpunojë me Operatorët e tjerë të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit (OST) si dhe do të dokumentojë që çdo marrëveshje për këtë qëllim do të jetë në fuqi jo më vonë se 2 muaj pasi të jetë miratuar përcaktimi i Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO);**

Referuar bashkëpunimit të ALPEX me Operatorët e tjerë të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit (OST), ju bëjmë me dije se në kuadër të operacionalizimit të ALPEX, i cili përkon me Lançimin e Tregut të Ditës në Avancë për Zonën Ofertuese të Shqipërisë (proces i përmbyllur me sukses) ndërmjet ALPEX sh.a dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a), ju bëjmë me dije se:

- Është nënshkruar “Marrëveshja për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga KOSTT sh.a tek ALPEX për organizimin e tregut të energjisë elektrike të një dite para, tregut ndër ditor dhe kalkulimet e barazimet përfundimtare”, me Nr. 2540 Prot, datë 16.12.2022, e cila ka për qëllim të përmbush detyrimet statutorë për operimin, administrimin, dhe vendimmarrjen për organizimin e tregut të energjisë elektrike të një dite para (DAM) për territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë të drejtën dhe përgjegjësitë për kalkulimin e barazimit përfundimtar (Clearing and Settlement), duke pranuar transferimin e të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me organizimin e DAM-it, IDM-së dhe për kalkulimin e barazimit përfundimtar për territorin e Republikës së Kosovës.
- Është nënshkruar “Marrëveshja Operacionale midis OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA (OST SHA) dhe BURSA SHQIPTARE E ENERJISË ELEKTRIKE SHA (ALPEX SHA)”, me Nr. 1832 Prot. datë 31.03.2023 (OST sh.a) dhe Nr. 107 Prot. datë 31.03.2023 (ALPEX sh.a).

Në përputhje dhe zbatim të:

- Ligjit Nr. 43/2015, dt. 30/04/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519 datë 13.7.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike, të ndryshuar;
- Vendimit të ERE Nr. 134, dt. 06.09.2017 “Mbi licencimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”;
- Vendimit të ERE Nr. 247, datë 29.09.2022 “Mbi licencimin e “Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX” SHA, në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike”;
- Vendimit të ERE Nr. 347, datë 27.12.2022 “Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e Alpex, përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes);
- Vendimit të ERE Nr. 106 datë 02.07.2020 “Rregullat e Tregut Shqiptar të balancimit të Energjisë Elektrike”, të ndryshuar;
- Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 106 dt. 23.03.2023,

është parashikuar krijimi i një kuadri të përmbledhur për bashkëpunimin ndërmjet OST dhe ALPEX, për zhvillimin nga ALPEX të ankandeve në Tregun e Ditës në Avancë (DAM), sipas objektit të mëposhtëm:

- ❖ Procedura e informimit të ALPEX mbi Rregjistrin e Palëve Përgjegjëse Balancuese

- të mbajtur nga OST;
- ❖ Sjellja e ALPEX në Tregun Shqiptar të Balancimit si PPB me të drejta të veçanta;
 - ❖ Blerja nga OST e humbjeve në transmetim në Bursën Shqiptare të Energjisë.

Në këtë marrëveshje midis të tjerave janë përcaktuar kontaktet kryesore dhe dytësore për komunikim/shkëmbim email-esh zyrtare ndërmjet OST dhe ALPEX.

Gjithashtu, nga ana e ALPEX është miratuar dhe “Procedura Operacionale”, e cila përcakton në mënyrë të detajuar të gjitha hapat, oraret, komunikimet, mënyrën e secilit proces (automatik apo manual), në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Tregtimit të miratuara nga ana Juaj.

Në kushtet ku, referuar marrëveshjes “Platfoma Elektronike e Tregtimit për Tregun e Ditës në Avancë dhe atë Brenda së Njëjtës Ditë, Infrastruktura dhe Shërbimet e Kërkuara për Operimin e Tregut të Organizuar në Shqipëri dhe Kosovë”, e amenduar, nënshkruar midis ALPEX sh.a dhe Ofruesit të Shërbimit, pritet që në muajin shtator 2023 ALPEX të fillojë me bashkimin e tregjeve të Shqipërisë dhe Kosovës për Ditën në Avancë, si projekti i parë i bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike brenda Ballkanit Perëndimor.

Në këtë kontekst, nga ana e ALPEX sh.a është kërkuar krijimi i një grupi të përbashkët pune midis ALPEX, OST, KOSTT, USAID dhe Ministrisë së Ekonomisë së Republikës së Kosovës, si dhe miratimi dhe zbatimi i një Plani konkret Veprimi me qëllim bërjen të mundur bashkimin e tregjeve të Shqipërisë dhe Kosovës për Ditën në Avancë sipas afateve të përcaktuara.

Ndër të tjera, në këtë Plan Veprimi është parashikuar hartimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjes Operacionale midis KOSTT dhe ALPEX – Dega Kosovë, e cila pritet të finalizohet sa më shpejt.

Gjithashtu, është parashikuar draftimi dhe nënshkrimi i:

- Marrëveshjes e të ardhurave nga kongjestioni (Congestion Agreement).
- Marrëveshja midis OST, KOSTT, ALPEX dhe ALPEX - Dega në Kosovë për klerimin ndërkufitar dhe Agjentin e Transaksioneve (Cross – border Clearing and Shipping Agent).
- Marrëveshja me ALPEX- Dega në Kosovë përsa i përket Agjentit të Transaksioneve.

Për sa më sipër, bashkëngjitur kësaj shkrese gjendet:

1. “Marrëveshja për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga KOSTT sh.a tek ALPEX për organizimin e tregut të energjisë elektrike të një dite para, tregut ndër ditor dhe kalkulimet e barazimet përfundimtare”, ndërmjet Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut sh.a (KOSTT) dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a – Dega Kosovë (ALPEX), me Nr. 2540 Prot, datë 16.12.2022;
2. “Marrëveshja Operacionale midis OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT SHA (OST SHA) dhe BURSA SHQIPTARE E ENERJISË ELEKTRIKE SHA (ALPEX SHA)”, me Nr. 1832 Prot. datë 31.03.2023 (OST sh.a) dhe Nr. 107 Prot. datë 31.03.2023 (ALPEX sh.a);
3. Procedura Operacionale e ALPEX.

Gjithashtu, sapo të finalizohen:

- Marrëveshja Operacionale midis OPERATORIT TË SISTEMIT, TRANSMISIONIT DHE TREGUT (KOSTT SHA) dhe BURSA SHQIPTARE E ENERJISË ELEKTRIKE SHA (ALPEX SHA)”.
- Marrëveshja e të ardhurave nga kongjestioni (Congestion Agreement).
- Marrëveshja midis OST, KOSTT, ALPEX dhe ALPEX - Dega në Kosovë për klerimin ndërkufitar dhe Agjentin e Transaksioneve (Cross – border Clearing and Shipping Agent).
- Marrëveshja me ALPEX- Dega në Kosovë përsa i përket Agjentit të Transaksioneve.

do t’ju vendosen në dispozicion nga ALPEX SH.A.

Nëpërmjet dokumentacionit bashkëngjitur dhe atyre që do të finalizohen vërtetohet se të gjitha marrëveshjet/procedurat janë apo do të jenë në fuqi jo më vonë se dy muaj pasi të jetë miratuar përcaktimi i Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO).

i) Shpjegim të detajuar në lidhje me procesin e identifikimit dhe menaxhimit të riskut si dhe planifikimi të përshtatshëm i menaxhimit të rasteve emergjente.

Në lidhje me menaxhimin e riskut përsa i përket procesit të klerimit janë përcaktuar në Vendimin Teknik nr.3-C. Fushëveprimi i këtij Vendimi Teknik ka të bëjë me;

- (a) përcaktimin e procedurës e menaxhimit të riskut të Sistemi i Klerimit të Tregut të Energjisë në zbatimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes për Transaksionet në Tregjet e ALPEX-it dhe çështje të tjera përkatëse.

- (b) specifikon metodologjinë e Llogaritjes së Margjinës së Kërkuar dhe Riskut Brenda së Njëjtës Ditë (Monitorimi i Kufirit të Kreditit).
- (c) përcaktimin e Garancisë së Pranueshme për mbulimin e Margjinës së Kërkuar.
- (d) rregullat për llogaritjen e Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve
- (e) rregullat e komunikimit.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.b:

Dërguar me shkresën me Nr. 161 Prot., datë 08.05.2023

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.c:

Sipas rastit, aplikuesi pritet të paraqesë dokumentet mbështetës të mëposhtëm:

1. Përshkrim të qartë dhe shpjegim të proceseve të llogaritjes të cilat do ti japin mundësinë aplikuesit të identifikojë dhe ndajë kostot e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO) dhe Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO);
2. Përshkrim të qartë dhe shpjegim të llogarive të veçanta të cilat do të përdoren për kostot e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO) dhe Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO);
3. Përshkrim të qartë të proceseve të raportimit të një analizimi të qartë të të gjitha kostove të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike, përfshirë shpenzimet e Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO);
4. Një krahasim i kostove të aplikuesit në lidhje me shembujt respektiv në Bashkimin Europian (BE) me kosto të ndara të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe Operatorit të Tregut të Bashkuar (MCO).

Të gjitha këto pika mund ti përmbledhim në një shpjegim të vetëm si në vijim:

Duke qenë se platformat janë vënë në dispozicion nga Ofruesi i Shërbimit dhe për këtë qëllim kemi një marrëveshje me Ofruesin e Shërbimit së bashku me çmimet përkatëse për këtë shërbim, kosto për Operatorin e Tregut të Bashkuar (MCO) dhe Operatorin e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) janë të përcaktuara në listën e çmimeve të këtij shërbimi dhe më konkretisht;

- PCR: Licenca për përdorim (tarifë vetëm një herë) është 24,608,000.00 Lekë
- PCR: Licenca për përdorim (tarifë vjetore) është 34,861,333.33 Lekë
- PCR, XBID: Licenca lidhja me infrastrukturën është 5,415,248.38 Lekë

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.d:

Shpjegimet janë dërguar me shkresën me Nr. 161 Prot., datë 08.05.2023

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.e:

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Aplikuesi pritet të paraqesë dokumentet mbështetës të mëposhtëm:

1. Një përshkrim dhe shpjegim të qartë të proceseve të tij të llogaritjes për çdo njërin prej aktiviteteve ligjore monopol.

Veprimtaria e ALPEX është e rregulluar nga Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” Neni 57 Operimi i tregut, pika 1, Operimi i tregut të energjisë elektrike kryhet nga operatori i tregut, i licencuar nga ERE. “Operatori i tregut është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e tregut të organizuar ndërmjet platformës së tregut, në bazë të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, si dhe për të gjitha aktivitetet e lidhura me të, duke përfshirë edhe aktivitetin e kompensimit financiar (clearing) mes pjesëmarrësve të tregut, në përputhje me rregullat dhe modelin e tregut. Operatori i tregut do të jetë Bursa Shqiptare e Energjisë.

Për këtë qëllim Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX SHA është licencuar nga Enti Rregullator i Energjisë – ERE për veprimtarinë e Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike Nr. 525 dt.29.02.2022, që është e vetmja veprimtari që kryen.

Modelit i Tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri, më konkretisht në Vendimin Nr. 872, Datë 27.12.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 519, Datë 13.7.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, Operatori i tregut - Bursa Shqiptare e Energjisë është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe operimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike nëpërmjet platformës elektronike të tregtimit, platformës elektronike të Klerimit dhe të shlyerjeve financiare për tregjet e ankandëve të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, si dhe tregjeve të vazhdueshme brenda së njëjtës ditë, ndërmjet anëtarëve të Bursës, në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike dhe rregullat e tregut të energjisë elektrike.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.f:

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentet mbështetës të mëposhtëm:

1. Një shpjegim të detajuar të procedurave për pjesëmarrësit e tregut të bashkuar dhe që do të përdorin shërbimet e aplikuesit të cilat nuk lejojnë diskriminimin e pjesëmarrësve të tregut;
2. Rregullat e tregut të cilat do të aplikohen për të gjithë pjesëmarrësit e tregut duhet të sigurojnë që nuk do të ketë diskriminim në treg;
3. Procedurat e brendshme duhet të përcaktohen me shkrim si dhe marrëveshjet funksionale, marrëveshjet kontraktore, dhe shërbimet për pjesëmarrësit e tregut të duhet mos jenë diskriminuese.

Pika 1 dhe 2 është mirë përcaktuar në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme. Pika 3 është shpjeguar në shkresën Nr. 161 Prot., datë 08.05.2023.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.g:

ALPEX është duke rishikuar strukturën e saj organizative me qëllim të harmonizimit të saj në funksion të aktivitetit për të cilin është krijuar si shoqëri dhe detyrimeve që rrjedhin nga licenca Nr. 525, datë 29.09.2022 “Për veprimtarinë e Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike”, të lëshuar nga ana Juaj (ERE) si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike, e cila pritet të propozohet pranë administratorit të ALPEX, në zbatim të Urdhrit të Brendshëm Nr. 19, Nr. 156 Prot., datë 04.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e strukturës organizative të ALPEX sh.a”, sipas afateve të përcaktuara.

Grupi i punës i ngritur për këtë qëllim është duke finalizuar propozimet me disa ndryshime të strukturës organizative që vijnë si rrjedhojë e rritjes së kapacitetit të ALPEX në kuadër të lançimit të Tregut të Ditës në Avancë në Shqipëri, si dhe nga kërkesat e Bashkimit të Tregjeve të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, duke paraqitur gjithashtu argumentet mbështetës për çdo propozim përkatës.

Në kuadër të plotësimit të kësaj pike është parashikuar krijimi i Drejtorisë së Monitorimit, siç dhe kërkohet nga Licenca e ALPEX.

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.h:

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Aplikuesi pritet të paraqesë dokumentet mbështetës të mëposhtëm:

1. Interpretim të detajuar të mënyrës se si aplikuesit do të vlerësojnë, miratojnë dhe zbatojnë marrëveshjet për transparencë dhe konfidencialitet me pjesëtarët aktuale dhe të ardhshëm të tregut dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit.

Në lidhje me pikën e parë, sqarimet janë dërguar me anë të shkresës Nr. 161 Prot., datë 08.05.2023.

2. Të paraqesë çdo marrëveshje ekzistuese që është në zbatim.

Këto kritere janë të përcaktuara dhe ushtrohen në përputhje me kushtet e Licensës Nr. 525, Seria O22, në cilësinë e të licensuarit në aktivitetin e operatorit të tregut të energjisë elektrike të ALPEX sh.a, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme të miratuara me Vendimin Nr. 347, datë 27.12.2022 të Bordit të ERE “Për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e alpex përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes), të ndryshuar.

Përsa i përket konfidencialitetit me pjesëtarët aktual dhe të ardhshëm të tregut, ALPEX ka parashikuar dispozita konfidencialiteti në Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë, e cila është e miratuar me anë të Vendimit Nr. 106, datë 23.03.2023 të Bordit të ERE “Mbi miratimin e disa shtesave në rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuar me Vendimin e Bordit të ER Nr. 347, datë 27.12.2022.”

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.i:

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentet mbështetëse të mëposhtme:

1. Shpjegim i detajuar i kostove të operimit dhe kërkesave të kolateralit si dhe mbajtja e tyre;
Për këtë pikë ALPEX i përmbahet në mënyrë rigoroze Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes miratuar në ERE me vendim **Nr. 347, datë 27.12.2022**, në të cilën janë përcaktuar në mënyrë të detajuar;
 - (a) se si dhe ku duhet të mbahet llogaria e kolateralit, e cila do të mbahet në një llogari bankare në të cilën do të dërgohen fonde për një pjesë ose të gjithë transaksionet që do të nominohen.
 - (b) si dhe nga cili duhet të sigurohet llogaria e kolateralit, ku është përcaktuar se si do të hapet dhe mbahet llogaria e kolateralit
 - (c) llojet e kolateralit, që është në para (cash) dhe Letër Garanci Bankare (LoG)
 - (d) formës së kolateralit, që është në monedhën Lekë ose Euro
 - (e) të drejtat mbi këtë kolateral etj.

2. Përshkrim dhe shpjegim i qartë i proceseve për të vendosur se cilat garanci nevojiten për shlyerje (likuidim):
Për këtë pikë ALPEX i përmbahet në mënyrë rigoroze Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes miratuar në ERE me vendim **Nr. 347, datë 27.12.2022**, në të cilën janë përcaktuar qartë rastet kur do të përdoret kjo garanci për shlyerjen e transaksioneve dhe hapat që do të ndiqen për realizimin e këtyre veprimeve.

3. Vlerësim i riskut dhe analizë studimore e bërë për të treguar përballimin e riskut në vazhdim;
Për këtë pikë ALPEX i përmbahet në mënyrë rigoroze Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes miratuar në ERE me vendim **Nr. 347, datë 27.12.2022**, në të cilën janë përcaktuar rastet e riskut dhe se si do të procedohet kur është në një situatë të tillë.

4. Përshkrimi i qartë dhe shpjegimi i mënyrës se si aplikuesit duhet planifikojnë të realizoj pagesën dhe shlyerjen, përfshirë:

- (a) Rregullat që aplikohen;
- (b) Kërkesat e pjesëmarrësve,
- (c) Proceset për pagesën dhe shlyerjen e detyrimeve, përfshirë atë me Operatorët tjerë të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit.

Në Vendimin Teknik Nr. 4-C Për "Procedurën e Shlyerjes në Para dhe Procedurën e Vetëfaturimit" është përcaktuar në mënyrë të detajuar se si do të jetë ky proces.

Ky Vendim Teknik përcakton çështjet e mëposhtme:

- (a) pjesëmarrësit në Shlyerjen në Para, ku përcaktohet kush janë entitetet pjesëmarrëse, mënyra e hapjes dhe mbajtjes së llogarive bankare të shlyerjes, mënyra e njoftimit dhe e verifikimit të të dhënave
- (b) parimet e përgjithshme të Procedurës së Shlyerjes në Para, ku përcaktohen ciklet dhe kushtet e shlyerjes .

5. Përshkrimin e qartë dhe shpjegimin e marrëveshjeve kontraktuale të nevojshme për të siguruar proceset e shlyerjes dhe likuidimit, përfshirë NEMO dhe OST e tjera dhe konfirmimin për marrëveshjet e operimit dhe ato kontraktuale të cilat lejojnë ose do të mundësojnë NEMO dhe OST e tjera që të funksionojnë në tregun e bashkuar të ditës në avancë dhe/ose atë brenda të njëjtës ditë.

Për këtë pikë ALPEX do të ketë Marrëveshjet përkatëse si;

-Marrëveshje midis OST, KOSTT, ALPEX, ALPEX-DEGA NË KOSOVË

-Marrëveshje midis OST-ALPEX dhe KOSTT-ALPEX për të ardhurat nga kongjestioni (congestion income)

-Marrëveshje midis ALPEX dhe ALPEX-DEGA NË KOSOVË

Kriteri i përcaktuar në Nenin 4.1.j dhe Neni 4.2 kanë përmbajtje identike dhe si rrjedhojë përmbledhen si vijon:

Dokumentacioni i nevojshëm si provë:

Sipas rastit, aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetëse të mëposhtme:

1. Përshkrim dhe shpjegim të mënyrës si do të komunikohet me Operatorët e Sistemit të Transmetimit; duke përfshirë marrëveshjet e pronësisë dhe marrëveshjet kontraktore për të vënë në punë dhe shërbim këtë pajisje:

Si një nga hallkat më të rëndësishme për operimin me sukses Tregjeve të ALPEX, është edhe komunikimi me Operatorin e Sistemit të Transmetimit e cila është e ndarë në dy pjesë:

- a) komunikimi zyrtar ndërmjet ALPEX dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit si një Anëtar i Bursës që lidhen për çështje jo teknike, por në kuadër të mirëfunksionimit të tregjeve, si dhe
- b) komunikimi i platformave që ka në përdorim ALPEX dhe OST.

Për komunikimet zyrtare ndërmjet ALPEX dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit që lidhen për çështje jo teknike, por në kuadër të mirëfunksionimit të tregjeve, ALPEX ka vendosur në faqen e internetit të tij të gjithë kontaktet e nevojshme për komunikime me palët apo Anëtarët e Bursës si dhe do të mund të komunikojnë shumë shpejt edhe duke përdorur komunikimet telefonike. Njëkohësisht ALPEX siç edhe ka shprehur në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike -Termet e Përgjithshme, seksioni C.3.2.2 i saj, e cila është e miratuar nga ERE, mund të përdorë edhe format e tjera të komunikimit me Anëtarët e Bursës dhe duke qenë se Operatori i Sistemit të Transmetimit është Anëtar i Bursës, ALPEX në këtë seksion ka parashikuar për komunikimin një nga format si vijon: duke përdorur postën elektronike (e-mail) apo Mjetin Elektronik të Emëruar. Këto sisteme komunikimi që janë përmendur më sipër do të zotërohen nga ALPEX dhe ALPEX për cdo ndryshim që do të bëjë do të vendosë në dijeni të gjithë Anëtarët e Bursës ku përfshihet edhe Operatori i Sistemit të Transmetimit.

Sa i përket komunikimit ndërmjet platformave që ka në përdorim ALPEX dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, ju bëjmë me dije që këto sisteme janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën nëpërmjet një lidhje web-based ku sistemet e production dhe ato test janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën duke përdorur si mjete sigurie krahas elementëve të brendshme të sigurisë që përdorin të dy kompanitë janë përdorur edhe si mjete shtesë sigurie edhe lëshimi i certifikatave të sigurisë që njihen nga të dy platformat. Për përsosjen e mënyrës së funksionimit si dhe arritjen e standarteve më të larta në komunikim dhe në anën e sigurisë janë realizuar shumë testime nga të dy anët në mënyrë që ky komunikim të jetë efikas dhe i sigurtë.

Në rast të ndonjë problematike në komunikimin automatik ndërmjet platformave që përdor ALPEX dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit atëherë për të zgjidhur këtë problematikë, ALPEX, në bashkëpunim me Ofruesin e Shërbimit ka një procedurë operacionale e cila aktivizohet në këto raste dhe shkëmbimi i të dhënave realizohet nëpërmjet mënyrave të komunikimit të shprehura më lart ku këto file do të dërgohen edhe do të marrin nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe do të ngarkohen në sistemet përkatëse në mënyrë manuale. Për këtë gjë, përpara kalimit të operimit të ALPEX Go-Live, janë realizuar shumë testime edhe për këtë qëllim në mënyrë të tillë që të simuloheshin edhe këto problematika dhe të bëhej shkëmbimi i informacionit në mënyrë manuale. Sa i përket çështjes së Tregtimit, në rast të

ndonjë problematike teknike me të dhënat e munguara në kohë mund të përmendim edhe Procedurën Alternative që ndjek ALPEX referuar tek Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike Procedura e Tregimit e miratuar edhe nga ERE dhe më konkretisht, kapitulli E i saj.

Gjithashtu, ALPEX, në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike - Procedura e Tregimit, kapitulli G, seksioni G.2, e miratuar nga ERE, ka paraqitur edhe Procedurat e Komunikimit.

2. Përshkrim dhe shpjegim i marrëveshjeve për rastet emergjente dhe planifikimi i menaxhimit të riskut

Sqarimi: Për përshkrimin e rasteve të tregimit emergjent në tregjet e ALPEX, vetë ALPEX ka parashikuar në procedurat e tij mënyrat që do të ndiqen për këto raste. Këto procedura janë të shprehura dhe të miratuara nga ALPEX dhe të publikuara në faqen e internetit të ALPEX nëpërmjet Vendimit Teknik Nr. 3-T Procedurat e tregimit emergjent në tregjet e ALPEX si dhe Vendimit Teknik Nr. 4-T që lidhet me çështjet teknike mbi skedarët e bisedave.

Për menaxhimin e riskut, ALPEX nëpërmjet Vendimit Teknik Nr. 3-C Procedura e menaxhimit të riskut në Sistemin e Klerimit dhe çështjeve të tjera ka parashikuar këtë procedurë.

3. Dokumentin e OST përkatëse ku konfirmohet pranimi i përshkrimit dhe shpjegimit të kërkuar më sipër dhe konfirmimi i OST që kjo mënyrë, software dhe hardware janë të pranueshme për OST.

Sqarimi: Për realizimin e komunikimit me OST si në rastet normale ashtu edhe në rastet përjashtimore apo emergjente, ALPEX në bashkëpunim me Ofruesin e Shërbimit si dhe me OST ka dakordësuar metodologjinë e komunikimit si dhe oraret e përshtatshme për shkëmbimin e këtyre të dhënave. Këto të dhëna janë dokumentuar në një dokument me emërtimin ALPEX ETSS/EMCS – TSO Interfaces.

Statement of work e cila është në vijim duke u përditësuar edhe me të dhënat e market Coupling si një nga detyrat e tjera për përmbushje nga ALPEX dhe në momentin e parë të përmbylljes së saj edhe me KOSTT, Ofruesin e Shërbimit dhe ALPEX, do Ju vendoset në dispozicion.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi të hapur për çdo kërkesë apo sqarim të mundshëm përsa më sipër.

Me respekt,

ADMINISTRATORI i ALPEX SHA

Sokol Dishnica



BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE – ALPEX SHA

Nr. 238 Prot

Tiranë, më 14.07.2023

Lënda: Plotësim i dokumentacionit të ALPEX sh.a për emërimin si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
Blvd. “Bajram Curri”, Rr. Viktor Eftimi 1023, Tiranë

I nderuar Z. Ahmeti,

Në vijim të shkresës tuaj Nr. 1395/6 Prot., datë 05.07.2023 “Njoftimi i Vendimit nr. 200, datë 23.06.202 dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni”, si dhe në vijim të shkresës Nr. 161 Prot., datë 08.05.2023 “Kërkesë për emërimin e ALPEX sh.a si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe shkresës Nr. 161/1 Prot., datë 08.05.2023 “Në lidhje me kërkesën e ALPEX sh.a për emërimin si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, plotësojmë dokumentacionin dhe japim shpjegim përkatëse sipas kërkesave tuaja.

Shtojca 1.b

Neni 4

Kriteret për përcaktimin e Operatorit të emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike

➤ **Dokumentacioni i nevojshëm si provë për plotësimin e nenit 4.1.a:**

Sipas rastit, aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm;

4. Plani financiar që projektin të ardhurat e këtij viti dhe të vitit pasardhës që nevojiten për kryerjen e detyrave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO);

Në vijim japim planin financiar që projektin të ardhurat e këtij viti dhe të vitit pasardhës që nevojiten për kryerjen e detyrave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) i cili përbëhet nga:

a. Pasqyrën e Pozicionit Financiar

Për plotësimin e kësaj pike, në vijim po japim informacion për pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbyllur 2022:

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2022

	Shënimet	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
AKTIVET			
Aktive afatgjate			
Aktive afatgjata materiale	5	9,445,386	11,188,487
Aktive te tjera afatgjata jo-materiale		-	-
Aktive te tjere financiare afatgjate(garanci kontrata)	6	3,338,417	3,338,417
Totali i aktiveve afatgjata		12,783,803	14,526,904
Aktive afatshkurtra			
Inventarë	7	1,050,072	314,865
Llogari të arkëtueshme të tjera	8	3,313,388	2,040,519
Mjetet monetare në arkë e në bankë	9	149,446,146	201,928,863
Totali i aktiveve afatshkurtra		153,809,605	204,284,248
Totali i aktiveve		166,593,408	218,811,152
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali aksionar	10	250,000,000	250,000,000
Rezerva përkthimi		(474,024)	(141,758)
Rezerva ligjore		-	-
Fitime/(Humbje të mbartura)		(32,601,526)	(1,576,276)
Fitimi (humbja) e vitit financiar	22	(52,016,754)	(31,025,249)
Totali i kapitalit		164,907,696	217,256,716
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata		-	-
Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime		-	-
Detyrime të tjera afatgjata		-	-
Provizione		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Detyrime afatshkurtra			
Huat afashkurte		-	-
Të pagueshme ndaj furnitorëve	11	696,650	72,433
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sig.shoqerore	12	420,554	389,729
Detyrime tatimore, TAP, Tatim ne burim, TVSH etj	13	300,792	345,220
Detyrime te tjera te pagueshme	14	267,716	747,053
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,685,712	1,554,435
Detyrime totale		1,685,712	1,554,435
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		166,593,408	218,811,152

b. Pasqyrën e fitimit dhe humbjeve dhe të Ardhurave gjithpërfshirëse

Për plotësimin e kësaj pike, në vijim po japim informacion për pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbyllur 2022:

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe Të Ardhurave të tjera gjithpërfshirëse më 31 Dhjetor 2022

		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	15		
Të ardhura të tjera	16	-	177,978
Total të ardhura		-	177,978
Materiale dhe shërbime direkte	17	(753,728)	(189,018)
Shpenzime personeli	18	(29,153,684)	(22,503,622)
Shpenzime amortizimi	19	(2,668,406)	(1,365,801)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	20	(18,630,549)	(6,775,346)
Total shpenzime		(51,206,366)	(30,655,810)
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)		-	-
Shpenzime të tjera financiare (neto)	21	(810,388)	(369,439)
Fitimi/humbja para tatimit		(52,016,754)	(31,025,249)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		-	-
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit	22	(52,016,754)	(31,025,249)
Fitimi/humbja per:			
Pronaret e njesise ekonomike meme	57.25%	(29,779,592)	(17,761,955)
Interesat jo-kontrolluese	42.75%	(22,237,162)	(13,263,294)
Rezerva përkthimi		(474,024)	(141,758)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		(474,024)	(141,758)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(52,490,778)	(31,167,007)
Totali i te ardhurave/humbjeve gjithperفشirese per:			
Pronaret e njesise ekonomike meme	57.25%	(30,050,970)	(17,843,112)
Interesat jo-kontrolluese	42.75%	(22,439,808)	(13,323,896)

c. Pasqyraën e Ndryshimeve në Kapital:

Për plotësimin e kësaj pike, në vijim po japim informacion për pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbyllur 2022:

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital më 31 Dhjetor 2022

	Kapitali i nënshkruar	Diferenca nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja	Fitimet/(humbjet) e pashperndara	Fitim/(humbja) e periudhes	Totali	Interesa jo-kontrollues	Totali
Pozicioni financiar ne fillim 1 janar 2021	250,000,000			(1,576,276)	248,423,724		248,423,724
Efekt i ndryshimeve ne politikat kontabile							
Pozicioni financiar i rideklaruar ne fillim	250,000,000			(1,576,276)	248,423,724		248,423,724
Te ardhurat totale gjithepershiresë te periudhes:							
Fitim/(humbja) e periudhes				(31,025,249)	(31,025,249)		(31,025,249)
Te ardhura te tjera gjithepershiresë		(141,758)	(1,576,276)	1,576,276	(141,758)		(141,758)
Ta time aktuale dhe te shtyra te njohura drejtperdrejt ne kapital							
Totali i te ardhurave gjithepershiresë per periudhen	-	(141,758)	(1,576,276)	(29,448,973)	(31,167,007)	-	(31,167,007)
Transaksione per pronaret e njesisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:							
Emetim i kapitalit të nënshkruar							
Dividende te shperndare							
Totali i transaksioneve per pronaret e njesisë ekonomike	-	-	-	-	-	-	-
Pozicioni financiar ne fund (viti paraardhes) 31.12.2021	250,000,000	(141,758)	(1,576,276)	(31,025,249)	217,256,716	-	217,256,716
Te ardhurat totale gjithepershiresë te periudhes:							
Fitim/(humbja) e periudhes				(52,016,754)	(52,016,754)		(52,016,754)
Te ardhura te tjera gjithepershiresë		(332,266)	(31,025,249)	31,025,249	(332,266)		(332,266)
Ta time aktuale dhe te shtyra te njohura drejtperdrejt ne kapital							
Totali i te ardhurave gjithepershiresë per periudhen	-	(332,266)	(31,025,249)	(20,991,505)	(52,349,020)	-	(52,349,020)
Transaksione per pronaret e njesisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:							
Emetim i kapitalit të nënshkruar							
Dividende te shperndare							
Totali i transaksioneve per pronaret e njesisë ekonomike	-	-	-	-	-	-	-
Pozicioni financiar ne fund (viti aktual)	250,000,000	(474,024)	(32,601,526)	(52,016,754)	164,907,696	-	164,907,696

d. Deklarim i qartë i supozimeve që janë përdorur si bazë e planifikimeve:

Në lidhje me këtë pikë, ju sqarojmë se për vitin 2023 të ardhurat janë planifikuar duke u bazuar në konsumin vjetor të energjisë elektrike gjatë vitit 2022 në tregun e Shqipërisë dhe në total janë konsumuar 7,783.00 GËh ku përmendim në Tregun e rregulluar për 35/20/10/6 dhe 0.4 kV konsumi ka qenë 3,950.00 GËh dhe në Tregun e parregulluar konsumi ka qenë 3,833.00 GËh.

Për planifikimin e të ardhurave për vitin 2023 kemi supozuar që 20% e kësaj energjie të konsumuar gjatë vitit 2022 ose 1,566.00 GËh do të tregtohet në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

Bazuar përsëri në këto të dhëna për planifikimin e të ardhurave për vitin 2024 është supozuar që 39% energjisë së konsumuar ose 3,217.00 GËh do të tregtohet në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, duke sjellë të ardhura per shoqërinë vetëm nga arkëtimi i tarifave variable të tregtimit dhe klerimit dhe planikimi i të ardhurave për tregun e Shqipërisë për vitin 2023 vetëm për tarifën variable është rreth 33.5 milion Lekë dhe për vitin 2024 vetëm për tarifën variable është rreth 69 milion Lekë.

Kurse për tregun e Kosovës, konsumi vjetor i energjisë elektrike gjatë vitit 2022 ka qenë 6,411 GËh dhe në planifikimin e të ardhurave për vitin 2023 është supozuar që 3% e energjisë së konsumuar në Kosovë do të tregtohet në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike ose 4.7 milion Lekë dhe që 10% e energjisë së konsumuar në Kosovë do të tregtohet në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike në vitin 2024 ose 14.49 milion Lekë vetëm për tarifën variable.

Gjithashtu në planikimin e të ardhurave për vitin 2023 dhe 2024 janë marr parasysh edhe të ardhurat nga tarifën fikse që vijnë kryesisht nga rregjistrimi i Anëtarëve të rinj në Bursë, ku për vitin 2023 janë parashikuar që do të rregjistrohen 10 Anëtar Burse dhe 3 Anëtar Klerimi në Shqipëri dhe 8 Anëtar Burse dhe 2 Anëtar Klerimi në Kosovë. Të ardhurat e planifikuara nga të gjitha tarifën fikse dhe variabël për vitin 2023 janë parashikuar rreth 59.64 milion Lekë për tregun e Shqipërisë dhe 25 milion Lekë për tregun e Kosovës dhe të ardhurat e planifikuara nga të gjitha tarifën për vitin 2024

janë parashikuar rreth 113.36 milion Lekë për tregun e Shqipërisë dhe 40 milion Lekë për tregun e Kosovës.

Më poshtë paraqesim në tabelë përlogaritjen e të ardhurave të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme sipas supozimeve për të dy tregjet:

Nr	Emërtimi	Njësia e matjes	Viti 2022	Parashikimi për vitin 2023	Parashikimi për vitin 2024
I.	Volumet në ALPEX - tregu i Shqipërisë DAM & IDM	GWh	0	1,566	3,217
	Përqindja of DAM vs Konsumit Total	%	0.0%	20.8%	39.2%
	Nr. Anëtarëve të Bursës	numër	0	10	18
	Nr. Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	numër	0	3	4
	Nr. Anëtarin e Personal të Klerimit	numër	0	3	4
II.	Tregu i Shqipërisë				
	Tarifa e Administrimit	Mln/Lekë	0.00	0.23	0.42
	Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	"	0.00	8.12	14.62
	Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës	"	0.00	11.60	20.88
	Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh	"	0.00	25.43	52.25
	SubTotali për Tarifat e Tregtimit	"	0.00	45.38	88.16
	Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit	"	0.00	0.70	0.93
	Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	"	0.00	2.09	2.78
	Tarifa e Aderimit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit	"	0.00	1.74	2.32
	Tarifa Variabël e Klerimit për MWh	"	0.00	7.27	14.93
	Tarifa Variabël e Klerimit për MWh për OTC	"	0.00	0.84	1.84
	Tarifa Depozitimit ose zëvendësimin e Letër Garancie	"	0.00	0.02	0.03
	Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin Personal	"	0.00	0.70	0.84
	SubTotali për Tarifat e Klerimit	"	0.00	13.35	23.67
	SubTotali për Tarifat e tjera	"	0.00	0.90	1.53
	Numri i Pjestarëve të Tregut	nr	0.00	13.00	22.00
	Numri mesatar stafit për tu trajnuar nga cdo PT	nr	0.00	0.90	1.53
TOTALI I TREGUT SHQIPTAR	"	0.00	59.64	113.36	

Nr	Emërtimi	Njësia e matjes	Viti 2022	Parashikimi për vitin 2023	Parashikimi për vitin 2024
III.	Volumet në ALPEX - tregu i Kosovës DAM & IDM	GWh	427.3	225.76	681.41
	Përqindja of DAM vs Konsumit Total	%	0.0%	3.6%	10.5%
	Nr. Anëtarëve të Bursës	numër	0	8.00	10.00
	Nr. Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	numër	0	2.00	3.00
	Nr. Anëtarin e Personal të Klerimit	numër	0	2.00	2.00
IV.	Tregu i Kosovës				
	Tarifa e Administrimit	Mln/Lekë	0.00	0.19	0.23
	Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	"	0.00	6.50	8.12
	Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës	"	0.00	9.28	11.60
	Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh	"	0.00	3.67	11.07
	SubTotali për Tarifat e Tregtimit	"	0.00	19.63	31.02
	Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit	"	0.00	0.46	0.46
	Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	"	0.00	1.39	2.09
	Tarifa e Aderimit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit	"	0.00	1.16	1.74
	Tarifa Variabël e Klerimit për MWh	"	0.00	1.05	3.16
	Tarifa Variabël e Klerimit për MWh për OTC	"	0.00	0.00	0.26
	Tarifa Depozitimit ose zevëndësimin e Letër Garancie	"	0.00	0.02	0.02
	Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin Personal	"	0.00	0.28	0.28
	SubTotali për Tarifat e Klerimit		0.00	4.36	8.01
	SubTotali për Tarifat e tjera		0.00	0.70	0.90
	Numri i Pjestareve të Tregut	nr	0.00	10.00	13.00
	Numri mesatar stafit për tu trajnuar nga cdo PT	nr	0.00	0.70	0.90
	TOTALI I TREGUT KOSOVAR	Mln/Lekë	0.00	25	40

e. **Një analizë studimore e parashikimit të ndryshimeve të dhëna sipas supozimeve të dhëna:**

Supozimet e dhëna në pikën d. mund të ndryshojnë sipas rastit dhe në varësi të disa faktorëve. Disa prej ndryshimeve që mund të ndikojnë në supozimin e të ardhurave i rendisimin në vijim:

1. Tregtimi i një volumi më të vogël nga parashikimi për vitin 2023, që si pasojë do të kishte uljen e të ardhurave të supozuara,
2. Tregtimi i një volumi më të madh nga parashikimi për vitin 2023, që si pasojë do të kishte rritjen e të ardhurave të supozuara,
3. Anëtarësimi i një numri më të vogël nga parashikimi për vitin 2023, që si pasojë do të kishte uljen e të ardhurave të supozuara,
4. Anëtarësimi i një numri më të madh nga parashikimi për vitin 2023, që si pasojë do të kishte rritjen e të ardhurave të supozuara.

f. **Një analizë e qartë e mënyrës se si aplikuesi planifikon të financojë operimin / funksionimin duke përfshirë detajet e garancive që kanë marrë aplikuesit për ti përdorur.**

Në lidhje me pjesën e parë se si aplikuesi planifikon të financojë operimin si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike planifikon të vetë financohet nëse arrihet të realizohet plani i parashikuar që deri në vitin 2025 të paktën mbi 50% e volumeve të konsumuara në Shqipëri të tregtohen në ALPEX dhe të paktën mbi 15% e volumeve të konsumuara në Kosovë të tregtohen në ALPEX. Në të kundërt do të financohet nga aksionarët që janë Operatori i Sistemit të Transmetimit – OST SHA dhe Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu – KOSTT SHA.

Më poshtë paraqesim në tabelë përlllogaritjen e të ardhurave sipas supozimeve për të dy tregjet për vitin 2025, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme, ku parashikohet që për tregun e Shqipërisë realizimi i të ardhurave të jetë në vlerën 151.67 milion Lekë kurse për tregun e Kosovës realizimi i të ardhurave të jetë në vlerën 51 milion Lekë, me një total të ardhurash për të dy tregjet në vlerën 202.67 milion Lekë.

Nr	Emërtimi	Njësia e matjes	Parashikimi për vitin 2025
I.	Volumet në ALPEX - tregu i Shqipërisë DAM & IDM	GWh	4,523
	Përqindja of DAM vs Konsumit Total	%	54.2%
	Nr. Anëtarëve të Bursës	numër	23
	Nr. Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	numër	4
	Nr. Anëtarin e Personal të Klerimit	numër	5
II.	Tregu i Shqipërisë		
	Tarifa e Administrimit	Mln/Lekë	0.53
	Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	"	18.68
	Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës	"	26.68
	Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh	"	73.45
	SubTotali për Tarifat e Tregtimit	"	119.34
	Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit	"	1.16
	Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	"	2.78
	Tarifa e Aderimit të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit	"	2.32
	Tarifa Variabël e Klerimit për MWh	"	20.99
	Tarifa Variabël e Klerimit për MWh për OTC	"	2.05
	Tarifa Depozitimit ose zëvendësimin e Letër Garancie	"	0.03
	Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin Personal	"	1.11
	SubTotali për Tarifat e Klerimit	"	30.45
	SubTotali për Tarifat e tjera	"	1.88
	Numri i Pjestarëve të Tregut	nr	27.00
	Numri mesatar stafit për tu trajnuar nga cdo PT	nr	1.88
TOTALI I TREGUT SHQIPTAR	"	151.67	

Nr	Emërtimi	Njësia e matjes	Parashikimi për vitin 2025
III.	Volumet në ALPEX - tregu i Kosovës DAM & IDM	GWh	1002.17
	Përqindja of DAM vs Konsumit Total	%	15.2%
	Nr. Anëtarëve të Bursës	numër	12.00
	Nr. Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit	numër	3.00
	Nr. Anëtarin e Personal të Klerimit	numër	3.00
IV.	Tregu i Kosovës		
	Tarifa e Administrimit	Mln/Lekë	0.28
	Tarifa e Anëtarësimit për Anëtarin e Bursës	"	9.74
	Tarifa Vjetore për Anëtarin e Bursës	"	13.92
	Tarifa Variabël e Tregtimit për MWh	"	16.28
	SubTotali për Tarifat e Tregtimit	"	40.22
	Tarifa Vjetore për Anëtarin Personal të Klerimit	"	0.70
	<i>Tarifa Vjetore për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit</i>	"	2.09
	Tarifa e Aderimit te Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit	"	1.74
	Tarifa Variabël e Klerimit për MWh	"	4.65
	Tarifa Variabël e Klerimit për MWh për OTC	"	0.46
	Tarifa Depozitimit ose zevëndësimin e Letër Garancie	"	0.02
	Mirëmbajtja e Llogarisë së Klerimit për Anëtarin Personal	"	0.28
	SubTotali për Tarifat e Klerimit		9.93
	SubTotali per Tarifat e tjera	"	1.04
	Numri i Pjestareve te Tregut	nr	15.00
	Numri mesatar stafit per tu trajnuar nga cdo PT	nr	1.04
TOTALI I TREGUT KOSOVAR	Mln/Lekë	51	

Kurse në lidhje me pjesën e dytë se si aplikuesi planifikon funksionimin duke përfshirë detajet e garancive që kanë marrë aplikuesit për ti përdorur, shpjegojmë që duke qenë se ALPEX është përgjegjës për operimin dhe funksionimin e të dy tregjeve të Shqipërisë dhe të Kosovës nuk planifikohet të marr apo të vendosë garanci në favor apo në emër të Degës së vet në Kosovë.

5. Një Plan Biznesi i cili lidhet me detyrat e tij si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), që përfshin:
 - c. Strukturën organizative përfshirë personelin dhe burimet njerëzore për funksionimin dhe, në mënyrë të veçantë, ato që kanë lidhje me ofrimin e shërbimit IT;

Me anë të Vendimit Nr. 5, datë 19/11/2020, Këshilli Mbikëqyrës i ALPEX sh.a ka miratuar Strukturën organizative të ALPEX sh.a dhe me Vendimin Nr. 14, datë 02/12/2021 ka miratuar disa ndryshime në Vendimin Nr. 5, datë 19/11/2020. Këto vendime kanë miratuar strukturën organizative aktuale të ALPEX sh.a, e cila është akoma duke u zbatuar.

- **Struktura organizative aktuale e Shoqërisë, e paraqitur në mënyrë skematike**

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE SHA

KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM

Nr.2, datë 13/07/2023

**“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË BURSËS SHQIPTARE TË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHA”**

Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike SHA, në mbështetje të Ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 “PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE”, i ndryshuar, dhe nenit 16 dhe 17 të Statutit të shoqërisë, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Administratori i shoqërisë me shkresën nr. 226 prot., datë 04/07/2023, në mbledhjen e tij të datës 13/07/2023, me unanimitetin e pjesëmarrësve në mbledhje;

VENDOSI:

1. Miratimin e Strukturës Organizative të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike SHA sipas Organogramës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e numrit të punonjësve të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike SHA gjithsej 23.
3. Vendimi nr.5, datë 19.11.2020 i Këshillit Mbikëqyrës të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike SHA “Për miratimin e Strukturës Organizative të ALPEX sh.a” dhe Vendimi Nr.14 datë 02/12/2021 i Këshillit Mbikëqyrës të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike SHA “Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin nr.5, datë 19.11.2020 “Për miratimin e Strukturës Organizative të ALPEX sh.a” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Shyqeri Morina

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës:


Znj. Ilda Nushi

Znj. Majlinda Demko


Znj. Kledia Ngjela

Sekretar i Këshillit Mbikëqyrës: Znj. Juliana Lamaj

STRUKTURA ORGANIZATIVE E ALPEX SH.A



[Handwritten signatures and initials]



Ndërkohë, në Planin Strategjik të Veprimtarisë së ALPEX sh.a., të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin Nr. 7 datë 24.02.2021 dhe nga Asambleja e Përgjithshme me vendimin Nr. 3 datë 25.02.2021 ishte parashikuar që kur ALPEX të jetë operacional organograma do të përshtatej sipas kërkesave të nevojshme në lidhje me operimin dhe aktivitetin e saj në tërësi. Numri i punonjësve i parashikuar në këtë Plan Strategjik ishte 17 punonjës në total.

Me qëllim ndryshimin e strukturës organizative, e cila vjen si rrjedhojë e rritjes së kapacitetit të ALPEX në kuadër të lançimit të Tregut të Ditës në Avancë në Shqipëri dhe përgatitjes për lançimin e Tregut të Ditës në Avancë në Kosovë, kërkesat e Bashkimit të Tregjeve të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, detyrimet që rrjedhin nga Licensa si operator tregu i ALPEX, si dhe detyrimeve që rrjedhin nga Rregullorja NEMO, ALPEX ngriti një grup pune me detyrë propozimin dhe argumentimin e hartimit të strukturës së re organizative të shoqërisë.

Për të hartuar propozimin e ndryshimeve në strukturën organizative, grupi i punës mori më shumë se një muaj kohë, për të reflektuar ndryshimet që ALPEX sh.a ka pësuar deri me tani dhe ndryshimet që priten në vijim për shoqërinë.

Për hartimin e propozimit të Strukturës Organizative, grupi i punës u mbështet në dokumentet si vijon:

1. Planin Strategjik të Veprimtarisë së ALPEX sh.a., të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin Nr. 7, datë 24.02.2021 dhe nga Asambleja e Përgjithshme me vendimin Nr.3, datë 25.02.2021.
2. Propozimet e Ofruesit të Shërbimit mbi strukturën organizative të ALPEX sh.a dhe funksionet në punë.

3. Dokumentin e Këshilluesit IFC- Nordpool Consulting, lidhur me aktivitetet që do të kryejë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a.
4. Eksperiencat e Bursave të rajonit të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian si edhe vendeve jo Anëtare të Bashkimit Evropian (të tilla si Bursa Kroate, Bursa Sllovene, Bursa e Maqedonisë së Veriut, etj).

Gjithashtu në hartim të strukturës organizative, rrjedhimisht dhe funksioneve në punë të cdo punonjësi në shoqëri, grupi i punës është bazuar në dokumentet vijuese:

Në Planin Strategjik të Veprimtarisë së ALPEX sh.a., të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin Nr. 7, datë 24.02.2021 dhe nga Asambleja e Përgjithshme me vendimin Nr. 3, datë 25.02.2021, si dhe bazuar në proceset e integritit të tregjeve Shqipëri, Kosovë dhe me vendet e tjera të rajonit janë nxjerrë në pah aktivitetet thelbësore të shoqërisë, të cilat lidhen me operimin e tregut, klerimin dhe shlyerjen.

Bazuar në këtë dokument, në të cilin është përcaktuar modeli i ndjekur nga vendet e rajonit për kontraktimin e platformave të nevojshme për operacionalizimin e ALPEX është kryer edhe procesi i prokurimit publik të kontratës me objekt “Platforma Elektronike e Tregtimit për Tregun e Ditës në Avancë dhe atë Brenda së njëjtës Ditë, Infrastruktura dhe Shërbimet e Kërkuara për Operimin e Tregut të Organizuar në Shqipëri dhe Kosovë”. Si rrjedhojë, Platforma e Tregtimit/Sistemi i Tregtimit të Energjisë në Çast – Electronic Trading Spot System (ETSS) është një dhe përfshin të dy zonat e ofertimit, pra atë të Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe Platforma e Klerimit dhe Shlyerjes/Sistemi i Klerimit të Tregut të Energjisë - Energy Market Clearing System (EMCS) është një dhe përfshin këto dy aktivitete thelbësore për Shqipërinë edhe Kosovën.

Bazuar në Marrëveshjen për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga KOSTT sh.a tek ALPEX - Dega në Kosovë për organizimin e tregut të energjisë elektrike të një dite para, tregut ndër ditë dhe kalkulimet e barazimet përfundimtar, është parashikuar se Platformat e tregtimit dhe të barazimit përfundimtar (clearing and settlement) si dhe platforma e menaxhimit të riskut do të jenë të njëjta për tregun e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Si rrjedhojë, operimi i tregut do të kryhet nga Zyrat Qëndrore të ALPEX në Tiranë, së bashku me proceset e Klerimit dhe Shlyerjes. ALPEX është në kordinim të vazhdueshëm me Degën në Kosovë për kryerjen e këtyre aktiviteteve thelbësore operationale të shoqërisë, si dhe më tepër për bashkimin e tregjeve të Shqipërisë dhe Kosovës të parashikuar më për të qenë gati teknikisht më Shtator 2023.

Duke u bazuar në parashikimet e “Rregullores së Kërkesave dhe Procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet dhe përgjegjësitë e NEMO dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar” (Rregullorja NEMO), bazuar në parashikimet e “Rregullores për Integritetin dhe Transparencën e Tregut me shumicë të Energjisë” (Rregullorja REMIT), parashikimet e Licensës së ALPEX të akorduar nga ERE si Operator i Tregut të Energjisë Elektrike, rrjedhin detyrimet e ALPEX sh.a për të siguruar një treg të

brendshëm konkurrues dhe të sigurt për të gjithë aktorët e tregut. Në kuadër të sugjerimeve të Ofruesit të Shërbimit dhe në funksion të Rregulloreve të lartpërmendura, është vënë theks në aktivitetin e Monitorimit të Tregut. Monitorimi i Tregut për ALPEX vjen si një kërkesë rregullatore dhe një element i rëndësishëm për t'i dhënë transparencë dhe garanci anëtarëve të bursës, duke garantuar që tregu të monitorohet për të mos lejuar deformime të mundshme apo abuzime të tregut. Ky detyrim është i parashikuar edhe në Planin Strategjik të ALPEX sh.a.

Duke u bazuar në detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor i ALPEX si një shoqëri publike, është parashikuar rritja e strukturës organizative në kapacitete të cdo Drejtorie/Sektorit dhe Degës.

Përsa i përket shërbimeve për mbështetje teknike dhe informatike dhe shërbimeve të sigurisë së informacionit, si dhe shërbimeve për rolin e auditit të brendshëm të kompanisë, grupi i punës propozoi që këto shërbime të mundësohen nga aksionarët e ALPEX, përkatësisht për ALPEX - Zyrën qendrore nga OST sh.a dhe për ALPEX - Dega në Kosovë nga KOSTT sh.a. Ky propozim vjen si rrjedhojë e sugjerimeve dhe eksperiencës së Ofruesit të Shërbimit, me qëllim uljen e kostove të kompanisë dhe duke patur parasysh punën jo të përditshme dhe minimale të funksioneve IT.

Me qëllim ofrimin e shërbimit të IT, ALPEX bazuar në Marrëveshjen me Ofruesin e Shërbimit ka garantuar sigurinë e të dhënave sensitive të tregtimit dhe të dhënave të klerimit për një periudhë 4 (katër) vjecare. Për këtë qëllim, ALPEX bazuar në Termat e Referencës së Kontratës me Ofruesin e Shërbimit (dokumenti i cili Ju është dërguar me aplikimin e parë të ALPEX) është vendosur që Serverat që ruajnë të dhënat e sipërpërmendura dhe mbajnë platformat/sistemet ndodhen në ambientet e Ofruesit të Shërbimit ATHEX që është Bursa e Titujve të Greqisë, kompani me eksperiencë të gjërë e cila ofron këto shërbime për Bursa e Titujve të Kuvajtit, Qirpos, Bullgarisë, Rumanisë dhe Serbisë.


Servat që ruajnë të dhënat dhe platformat/sistemet e ALPEX-it ruhen në mënyrë të vecuara. Për më tej Ofruesi i Shërbimit ka ofruar për ALPEX një Plan emergjent për rikuperimin e të dhënave në rastet e emergjencave (Disaster Recovery).

Sistemi i email-eve dhe sistemi i sigurisë së sistemeve operative të funksionimit të kompjuterave, ALPEX e ka kontraktuar me Microsoft-in nëpërmjet paketës Microsoft Office 365, në të cilën ruhen dhe të dhënat e tregtimit në një llogari në cloud.

Ndërkohë lidhur me pajisjet hardëare dhe sigurinë e brendshme, ALPEX-i merr asistencë nga stafi i IT i OST-së.

Struktura organizative e paraqitur në mënyrë skematike:

STRUKTURA ORGANIZATIVE E ALPEX SH.A



Numri i punonjësve 23

Ju bëjmë me dije se Struktura e sipërpermendur, është miratuar me Vendimin Nr. 2, datë 13.07.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike sh.a” të Këshillit Mbikëqyrës të ALPEX sh.a.

Ky vendim ka hyrë në fuqi menjëherë dhe si rrjedhojë janë shfuqizuar të gjitha vendimet e mëparshme të Këshillit Mbikëqyrës të ALPEX sh.a në lidhje me strukturën organizative të shoqërisë.

Ndryshimi i kësaj Struktura dikton ndryshimin e Programit Ekonomik të shoqërisë për vitin 2023 dhe vitet në vijim. Për këtë qëllim bashkëlidhur kësaj shkresë do të gjeni një draft paraprak të programit ekonomik, i cili do të përcillet për miratim pranë organeve qeverisëse të ALPEX dhe me miratimin e tij do Ju vendoset në dispozicion.

Gjithashtu ALPEX është në kushtet e negocimit të marrëveshjes për shërbimin IT me palën pronare OST dhe KOSTT, por theksojmë se për shkak të ndërtimit të platformës dhe funksionimit të saj nëpërmjet lidhjes me rrjetin, shërbimet IT të nevojshme për ALPEX përmbushen nga Ofruesi i Shërbimit.

- h. Shpjegim i detajuar i planit se si aplikuesi ka për qëllim të bashkëpunojë me Operatorët e tjerë të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit (OST) si dhe do të dokumentojë që çdo marrëveshje për këtë qëllim do të jetë në fuqi jo më vonë se 2 muaj pasi të jetë miratuar përcaktimi i Operatorit të Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO);

Bazuar në Marrëveshjen për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga KOSTT sh.a tek ALPEX - Dega në Kosovë për organizimin e tregut të energjisë elektrike të një dite para, tregut ndër ditor dhe kalkulimet e barazimet përfundimtar, është parashikuar se Platformat e tregtimit dhe të barazimit përfundimtar (clearing and settlement) si dhe platforma e menaxhimit të riskut do të jenë të njëjta për tregun e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Si rrjedhojë, operimi i tregut do të kryhet nga Zyrat Qëndrore të ALPEX në Tiranë, së bashku me proceset e Klerimit dhe Shlyerjes. ALPEX është në kordinim të vazhdueshëm me Degën në Kosovë për kryerjen e këtyre aktiviteteve thelbësore operationale të shoqërisë, si dhe më tepër për bashkimin e tregjeve të Shqipërisë dhe Kosovës të parashikuar më për të qenë gati teknikisht më Shtator 2023.

Referuar bashkëpunimit të ALPEX me Operatorët e tjerë të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe Operatorët e Sistemit të Transmetimit (OST), në kuadër të lancimit të tregut të ditës në avancë për zonën ofertuese të Shqipërisë, si dhe punës përgatitore për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Zonës Ofertuese të Shqipërisë dhe Zonës Ofertuese të Kosovës ndërmjet ALPEX sh.a, Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a), dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT sh.a), janë nënshkruar si vijon:

- “Marrëveshja për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga KOSTT sh.a tek ALPEX-Dega në Kosovë për organizimin e tregut të energjisë elektrike të një dite para, tregut ndër ditor dhe kalkulimet e barazimet përfundimtare”, me Nr. 2540 Prot, datë 16.12.2022, e cila ka për qëllim të përmbush detyrimet statutores për operimin, administrimin, dhe vendimmarrjen për organizimin e tregut të energjisë elektrike të një dite para (DAM) për territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë të drejtën dhe përgjegjësitë për kalkulimin e barazimit përfundimtar (Clearing and Settlement), duke pranuar transferimin e të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me organizimin e DAM-it, IDM-së dhe për kalkulimin e barazimit përfundimtar për territorin e Republikës së Kosovës.
- “Marrëveshja Operationale midis Operatorit të Sistemit të Transmetimit sha (OST sha) dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sha (ALPEX sha)”, me Nr. 1832 Prot. datë 31.03.2023 (OST sh.a) dhe Nr. 107 Prot. datë 31.03.2023 (ALPEX sh.a). (E cila është depozituar pranë Jush me aplikimin e ALPEX).

Në përputhje dhe zbatim të:

- Ligjit Nr. 43/2015, dt. 30/04/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519 datë 13.7.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike, të ndryshuar;
- Vendimit të ERE Nr. 134, dt. 06.09.2017 “Mbi licencimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”;
- Vendimit të ERE Nr. 247, datë 29.09.2022 “Mbi licencimin e “Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX” SHA, në veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike”;
- Vendimit të ERE Nr. 347, datë 27.12.2022 “Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e Alpex, përkufizimet, procedura e tregtimit si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes);
- Vendimit të ERE Nr. 106 datë 02.07.2020 “Rregullat e Tregut Shqiptar të balancimit të Energjisë Elektrike”, të ndryshuar;
- Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 106 dt. 23.03.2023,
- Vendimit të ZRrE Nr. V_1638_2022, datë 27.12.2022 “Për aprovimin e Rregullave dhe Procedurave (Kushtet e Përgjithshme, Përkufizimet, Procedura e tregtimit si dhe Procedura e klerimit dhe shlyerjes) e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX);
- Vendimit të ZRrE Nr. V_1637_2022 datë 27.12.2022 “Për aprovimin lidhur me transferimin e të drejtave dhe detyrimeve për organizimin e tregut një ditë para, tregut ndër ditor dhe kalkulimet e barazimit përfundimtar nga Operatori i Tregut/KOSTT sh.a tek Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a-Dega në Kosovë (ALPEX).

është parashikuar krijimi i një kuadri të përmbledhur për bashkëpunimin ndërmjet OST dhe ALPEX, për zhvillimin nga ALPEX të ankandeve në Tregun e Ditës në Avancë (DAM), sipas objektit të mëposhtëm:

- ❖ Procedura e informimit të ALPEX mbi Rregjistrin e Palëve Përgjegjëse Balancuese të mbajtur nga OST;
- ❖ Sjellja e ALPEX në Tregun Shqiptar të Balancimit si PPB me të drejta të veçanta;
- ❖ Blerja nga OST e humbjeve në transmetim në Bursën Shqiptare të Energjisë.

Në këtë marrëveshje (Marrëveshja Operacionale, dokumenti i dërguar nga ALPEX me aplikimin për emërimin si NEMO) midis të tjerave janë përcaktuar kontaktet kryesore dhe dytësore për komunikim/shkëmbim email-i zyrtar ndërmjet OST dhe ALPEX.

Marrëveshja e parashikuar ndërmjet ALPEX – Dega në Kosovë dhe KOSTT sh.a është në fazën përfundimtare, përpara nënshkrimit të saj nga palët. Në momentin e nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, ALPEX do Ju percjell finalizimin e kontratës.

Gjithashtu, nga ana e ALPEX është miratuar dhe “Procedura Operacionale”, e cila përcakton në mënyrë të detajuar të gjitha hapat, oraret, komunikimet, mënyrën e secilit proces (automatik apo manual), në përputhje me Rregullat e ALPEX – Procedura e Tregtimit.

Në kushtet ku, referuar kontratës “Platfoma Elektronike e Tregtimit për Tregun e Ditës në Avancë dhe atë Brenda së Njëjtës Ditë, Infrastruktura dhe Shërbimet e Kërkuara për Operimin e Tregut të Organizuar në Shqipëri dhe Kosovë”, e amenduar, nënshkruar midis ALPEX sh.a dhe Ofruesit të Shërbimit, pritet që në muajin shtator 2023 ALPEX të fillojë me lancimin e tregut të ditës në avancë për zonën e ofertimit të Kosovës dhe njëkohësisht bashkimin e tregjeve të Shqipërisë dhe Kosovës, si projekti i parë i bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike brenda Ballkanit Perëndimor.

Në këtë kontekst, nga ana e ALPEX sh.a është kërkuar krijimi i një grupi të përbashkët pune midis ALPEX, OST, KOSTT, USAID dhe Ministrisë së Ekonomisë së Republikës së Kosovës, si dhe miratimi dhe zbatimi i një Plani konkret Veprimi me qëllim bërjen të mundur bashkimin e tregjeve të Shqipërisë dhe Kosovës për Ditën në Avancë sipas afateve të përcaktuara.

Ndër të tjera, në këtë Plan Veprimi është parashikuar hartimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjes Operacionale midis KOSTT dhe ALPEX, e cila pritet të finalizohet sa më shpejt.

Gjithashtu, Marrëveshjet e mëposhtme janë në fazën e hartimit dhe negocimit:

- Marrëveshjes së të ardhurave nga kongjestioni (Congestion Agreement).
- Marrëveshjes për klerimin ndërkufitar (Cross – border Clearing).
- Marrëveshja përsa i përket Agjentit të Transaksioneve (Transaction Agent).
- Marrëveshja Operacionale midis Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT SHA) dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike Sha (ALPEX SHA)”.
- Marrëveshja midis SEE CAO, OST, KOSTT dhe ALPEX, për Shadow Allocation Rules, e cila do të nënshkruhet pasi ALPEX të emërohet si NEMO për të dyja zonat ofertuese të Shqipërisë dhe Kosovës.

Me finalizimin e tyre, këto Marrëveshje do t’ju vendosen në dispozicion nga ALPEX SH.A. ALPEX ka marrë të gjitha masat dhe angazhimet e nevojshme për të siguruar nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të gjitha marrëveshjeve të sipërpërmendura, jo më vonë se 2 (dy) muaj nga miratimi i përcaktimit si NEMO.

Për sa më sipër, bashkëngjitur kësaj shkrese gjendet:

- Marrëveshja për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga KOSTT sh.a tek ALPEX-Dega në Kosovë për organizimin e tregut të energjisë elektrike të një dite para, tregut ndër ditë dhe kalkulimet e barazimet përfundimtare”, me Nr. 2540 Prot, datë 16.12.2022.

Nëpërmjet dokumentacionit bashkëngjitur dhe atyre që do të finalizohen vërtetohet se të gjitha marrëveshjet/procedurat janë apo do të jenë në fuqi jo më vonë se dy muaj pasi të jetë miratuar emërimi i ALPEX si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

- i. Shpjegim të detajuar në lidhje me procesin e identifikimit dhe menaxhimit të riskut si dhe planifikimi të përshtatshëm i menaxhimit të rasteve emergjente. Informacion në lidhje me trajtimin e emergjencave.

Në kuadër të garantimit të operimit të sigurtë dhe pa probleme në rastet e emergjencave apo keqfunksionimeve të sistemeve (ETSS dhe EMCS), ALPEX-i ka parashikuar në mënyrë të detajuar masat dhe mekanizmat që do të përdoren me qëllim trajtimin e këtyre rasteve emergjente. Këto parashikime shprehen në seksionin F.2.1.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Termat e Përgjithshme, të cilat janë të miratuara nga ana Juaj, ku është shprehur që Sistemi Elektronik i Tregtimit në Çast ETSS (Electronic Trading Spot System) dhe Sistemi i Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS) ka një tjetër sistem Back-up, i cili në vetvete është sistem i pavarur elektronik dhe që do të aktivizohet në rast të mosfunksionimit të sistemit kryesor.

Njëkohësisht, për garantimin e sigurtë dhe pa probleme të Tregtimit, në seksionin G.3, Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër, të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Tregtimit, e miratuar nga ana Juaj, është e parashikuar qartë se çfarë ndodh në rastet kur rrjeti nuk punon ose në rast të ndonjë problemi tjetër teknik ose funksional që pengon një Anëtar të Bursës të vendosë/modifikojë/fshijë urdhërporosi në ETSS.

Gjithashtu, sa i përket garantimit të sigurisë dhe përputhshmërisë së ndërlidhjes së rrjetit të një Anëtari të Bursës me sistemin ETSS që përdor ALPEX janë parashikuar edhe detaje të tjera të hollësishme për të ndihmuar një Anëtar të Bursës për këtë qëllim. Këto të dhëna janë të parashikuara në seksionin G.1.2, Aksesit teknik, të Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Tregtimit, e miratuar nga ERE. Për çështje sigurie, ALPEX ju lejon akses për përdorim në sistemet e veta vetëm përdoruesve të autorizuar siç është parashikuar në seksionin F.2.3 të Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Termat e Përgjithshme, e miratuar nga ERE.

Për sa më sipër përmendur, procedura “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër”, është parashikuar dhe detajuar në Vendimin Teknik Nr. 2 – T “Procedurat e tregtimit emergjent në Tregjet e ALPEX”, objekti i të cilit është të përcaktojë mekanizmat dhe procedurat alternative të tregtimit në rast të keq funksionimit të Sistemit të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) ose emergjencave të tjera, me qëllim ruajtjen e funksionimit të duhur të Tregjeve të ALPEX-it dhe mbrojtjen e interesave të Anëtarëve të Bursës.

Në këtë vendim janë parashikuar veprimet që ndërmerren në rastet përjashtimore nga tregtimi i zakonshëm, Klerimi dhe Shlyerja ose emergjenca të tjera. Në rast të keq funksionimeve të rrjetit, keq

funksionimeve të sistemit ETSS, keq funksionimeve të komunikimit të Sistemit të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) me Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS), apo keq funksionimeve në sistemet periferike, ALPEX do të garantojë se:

- është zbuluar keq funksionimi dhe sistemi i menaxhimit për këtë problem do të aktivizohet;
- janë ndërmarrë veprime korigjuese, dhe
- veprimet për zgjidhjen e keq funksionimit regjistrohen, duke informuar Anëtarët e Bursës me çdo mjet të përshtatshëm për problemin.

Procedura për mbështetjen e Tregtimit të Anëtarëve të Bursës parashikon se në rast të keq funksionimeve teknike të sistemeve të Anëtarëve të Bursës ose emergjencave të tjera, ALPEX-i u mundëson Anëtarëve të Bursës akses në ETSS nëpërmjet shërbimit “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër” të ALPEX siç përshkruhet në seksionin G.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurat e Tregtimit.

Në këtë rast, Agjentët Tregtar të Certifikuar, të cilët tashmë janë të regjistruar në bazën e të dhënave të Anëtarëve të Bursës, mund të aplikojnë nëpërmjet një linje telefonike të regjistruar ose nëpërmjet Mjetit Elektronik të Emëruar (i cili do të sigurohet nga ALPEX-i) për ndihmën e ALPEX-it, për dorëzimin e një Urdhërporosie të re në ETSS, për modifikimin ose për anulimin e një urdhërporosie të dorëzuar, duke plotësuar të gjitha fushat e detyrueshme të Urdhërporosisë me ndihmën e ALPEX-it dhe në çdo rast 20 (njëzetë) minuta përpara Kohës përkatëse të Mbylljes së Portës. ALPEX-i do të kërkojë gjithashtu konfirmimin e Urdhërporosisë, nëpërmjet një formulari të përshtatshëm për regjistrimin e fushave të detyrueshme të Llojeve të Urdhërporosive, të ofruara nga ALPEX-i. Anëtari i Bursës nuk mund të pretendojë se Urdhërporositë janë dorëzuar në ETSS nëse nuk kanë marrë një konfirmim me shkrim nga ALPEX-i. Për më tepër, ALPEX nuk do të garantojë disponueshmërinë e numrit të mjaftueshëm të linjave telefonike. Shërbimi “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër” mund të përdoret vetëm për D-1 (orët e punës), në kuadër të Ditës së Livrimit. Nëse paraqitet një numër i madh kërkesash, ALPEX-i do të dorëzojë Urdhërporositë duke u bazuar në parimin e përparësisë kohore, përveç rasteve kur ka arsye për ruajtjen e funksionimit të mirë të tregut ose parandalimin e rreziqeve për Klerimin e Transaksioneve, që justifikojnë shmangien nga parimi i sipërpërmendur. Në çdo rast, plotësimi i kërkesës është parakusht për ofrimin e shërbimit.

Detajet teknike të regjistrimit të bisedave telefonike apo ruajtjes së shkëmbimit të të dhënave për shërbimin “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër”, paraqiten si më poshtë:

- ALPEX do të regjistrojë bisedat telefonike apo do të ruajë shkëmbimet e të dhënave që lidhen me dorëzimin e Urdhërporosive të reja në ETSS, modifikimin ose anulimin e një Urdhërporosie të dorëzuar, duke marrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë.
- ALPEX do të verifikojë identitetin e telefonuesit përpara se të kryejë shërbimin “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër”.

- Numri/at e telefonit për komunikimet me ALPEX-in do të postohen në faqen zyrtare të ueb-it të ALPEX www.alpex.al.
- Nuk lejohet kryerja e shërbimit “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër” nga numra të tjerë të telefonit të Agjentëve Tregtar të Certifikuar, përveç atyre të dhëna në Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë.

Sipas Modelit Evropian mbi funksionimin e Bursave dhe trajtimin e rasteve emergjente, ALPEX në bashkëpunim me Ofruesin e Shërbimit kanë krijuar një mekanizëm i cili quhet Incident Call Meeting, i ngjashëm me mekanizmin që përdor SDAC. Ky mekanizëm brenda disa minutash do të trajtojë të gjitha çështjet e emergjencës që lidhen me tregtimin dhe klerimin, për ti dhënë zgjidhje të shpejtë dhe eficiente.

Në këto mbledhje marrin pjesë ALPEX-i dhe Ofruesi i Shërbimit të ALPEX.

Përsa më sipër, bashkëngjitur do të gjeni:

1. Vendimin Teknik Nr. 3-T “Procedurat e tregtimit emergjent në Tregjet e ALPEX-it”.
- **germa “b”**. Duhet të jetë në gjendje të sigurojë akses të hapur për informacion për pjesëmarrësit e tregut në lidhje me detyrat e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) sipas përcaktimeve të Nenit 5.

➤ **Dokumentacioni i nevojshëm si provë për plotësimin e nenit 4.1.b:**

Sipas rastit, aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Një strategji të qartë komunikimi që përfshin:
 - a. Përshkrim dhe dëshmi për vendin dhe mënyrën si pjesëmarrësit e tregut do të kenë mundësinë për të patur akses në informacion;
 - b. Proçesin e publikimit të të dhënave;
 - c. Përshkrim i planeve për rastet emergjente dhe garancia që ky informacion është në dispozicion të gjithë pjesëmarrësve të tregut.

Përsa i përket strategjisë së qartë të komunikimit, Ju informojmë si vijon.

ALPEX sh.a, në përputhje me kushtet e Licensës Nr. 525, Seria O22, në cilësinë e të licensuarit në aktivitetin e operatorit të tregut të energjisë elektrike nga ERE, ka siguruar akses të hapur për informacion për të gjithë pjesëmarrësit e tregut, nëpërmjet publikimit dhe përditësimeve në faqen e tij zyrtare të internetit të të dhënave të sasive të blerjes dhe shitjes për Njësi Kohore Tregu për çdo portofol (në anonim), publikimit të Anëtarëve të Bursës, Anëtarët e Përgjithshëm të Klerimit, oraret

dhe datat për trajnimet dhe provimet e agjentëve tregtarë dhe agjentëve klerues, si dhe çdo të dhënë tjetër sipas parashikimeve në Rregullat e ALPEX - Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat.

Për më tepër, midis ALPEX dhe cdo Anëtari të Bursës nënshkruhet Marrëveshja e Anëtarësimit në Bursë, në formatin standard të miratuar nga Ju me Vendimin Nr. 106, datë 23.02.2023.

Kjo Marrëveshje në nenin 11.1 “Njoftimet”, parashikon mënyrën e njoftimit që kërkohet të behët sipas Marrëveshjes apo Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat nga Anëtari i Bursës. Të gjitha njoftimet do të jepen me shkrim nga Palët apo përfaqësuesit e autorizuar të tyre, përfaqësuesve të autorizuar të ALPEX-it.

Për më tepër, kjo Marrëveshje në Nenin 12 “Komunikimet”, parashikon se cdo komunikim ndërmjet palëve, do të dërgohet me shkrim, nëpërmjet telefonit, ose me e-mail, me kusht që të ketë një vërtetim me shkrim të marrjes. Për këtë qëllim janë caktuar personat përgjegjës për tregtimin, të cilët janë të caktuar nga Anëtari i Bursës dhe kanë si detyrë të informojnë Anëtarin e Bursës për cdo rast dhe problem në lidhje me ALPEX-in. Këta persona veprojnë si personat e kontaktit për të gjithë komunikimin ndërmjet palëve. Për këtë qëllim këta persona caktohen me nënshkrimin e Marrëveshjes së Anëtarësimit në Bursë, në Shtojcën Nr. 2 të kësaj Marrëveshje. Sipas parashikimeve, e vetmja mënyrë e ndryshimit të personave përgjegjës për tregtimin (personat e kontaktit) është nëpërmjet një Njoftimi me shkrim nga Anëtari i Bursës kundrejt ALPEX-it.

Përsa i përket pikës a) “Përshkrim dhe dëshmi për vendin dhe mënyrën si pjesëmarrësit e tregut do të kenë mundësinë për të patur akses në informacion”, Ju informojmë si vijon.

Referuar sqarimeve dhe informacionit të dhënë nga ana Jonë në aplikimin për përcaktimin si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike, si dhe konstatimit të bërë nga ana Juaj (në Vendimin Nr. 200, datë 23.06.2023 dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit), del e qartë se pika a) “Përshkrim dhe dëshmi për vendin dhe mënyrën si pjesëmarrësit e tregut do të kenë mundësinë për të patur akses në informacion” është ezauruar nga ALPEX, duke u provuar ekzistenca dhe përditësimi i vazhdueshëm i faqës së ueb-it të shoqërisë. Për këtë qëllim ALPEX aktualisht ka në fuqi një kontratë për menaxhimin e faqes së internetit të tij, e cila do të shtjellohet në pikën vijuese.

Për më tej, ALPEX me Urdhër të Brendshëm ka caktuar një grup pune i cili është përgjegjës për ndjekjen dhe asistimin kundrejt Anëtarëve në procesin e Anëtarësimit në Bursë. Ky grup pune, informon të gjithë Anëtarët e Bursës për cdo vendimmarrje të ALPEX që prek të drejtat e këtyre Anëtarëve, si dhe cdo rregull, procedurë, informacion apo metodologji përkatëse.

Përsa i përket pikës b) “Proçesi i publikimit të të dhënave”, Ju informojmë si vijon.

Si dhe lartpërmendur, ALPEX aktualisht ka në fuqi një kontratë për menaxhimin e faqes së internetit të tij, ku janë të përcatuara detyrimet e përditësimit në mënyrë të vazhdueshëm të faqes së internetit të ALPEX 24/7 me të dhënat e detyruara për publikim sipas Rregullave të ALPEX- Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat, të miratuara nga Bordi i ERE dhe ZRRë.

Përsa më sipër kërkuar, me qëllim publikimin dhe informimin kundrejt Anëtarëve të Bursës, ALPEX në Kontratën me kompaninë e cila menaxhon faqen e internetit, ka parashikuar disa dispozita që imponojnë kontraktorin, ndër të tjera, të:

- Ofrojë një platformë hostimi të qëndrueshme, të besueshme dhe të sigurtë për hostimin e faqes/fletës ëeb të internetit www.alpex.al
- Sigurojë mbështetje 24/7 për zhvilluesit e portalit në identifikimin e shkaqeve të problemeve dhe realizimin e konfigurimeve që kërkohen për rregullimin e tyre;
- Monitorojë, mirëmbajë dhe përditësojë në mënyrë të vazhdueshme mjedisin e hostimit të portalit, të bashkëpunojë me personat përkatës për përditësimin e sistemit sikurse të jetë pjesëmarrës aktiv në implementimin e përditësimeve të sistemit sa herë që kërkohet nga ALPEX si dhe në cdo moment gjatë të gjithë periudhës së zgjatjes së kontratës;
- Sigurojë ruajtjen periodike të backup-ve të faqes/ fletës ëeb: kodin, bazën e të dhënave dhe materialet apo çdo material tjetër që është i nevojshëm;
- Në rast të ndonjë incidenti serioz, duhet të garantohet rivendosja e faqes/ fletës ëeb sipas të dhënave të backup-it më të fundit dhe në mënyrë të menjëhershme;
- Menaxhojë të gjitha aspektet e sigurisë së faqes/ fletës ëeb për të mbrojtur përmbajtjen e faqes/ fletës;
- Monitorojë 24/7 ambjentin e hostimit;
- Sigurojë mirëmbajtjen dhe përditësimin e vazhdueshëm të ambjentit të hostimit sa herë që kërkohet nga ALPEX si dhe në cdo moment gjatë të gjithë periudhës së zgjatjes së kontratës;
- Në rast sulmesh kibernetike duhet të marrë masa të menjëhershme për të garantuar qëndrueshmërinë online të sistemit;
- Në raste defekti hardëare duhet të garantojë që sistemi brenda 30 min të jetë përsëri online dhe gjatë kohës së defektit duhet të lajmërojë përdoruesit për kohën e saktë kur pritët që sistemi të jetë online me të gjithë informacionin e plotë;
- Sigurojë përditësimin e sistemit operativ të mjedisit ku do të hostohet portali ëeb;
- Përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar përmirësimin e ndërfaqes së përdoruesit në pajisje të ndryshme (desktop dhe mobile);
- Mirëmbajë dhe përmirësojë funksionalitetet e faqes;
- Pasurojë faqen sipas kërkesave të ALPEX dhe sa herë që kërkohet;
- Menaxhimojë, përditësojë dhe përmirësojë navigimin dhe arkitekturën e informacionit;
- Menaxhimojë design-in; përmirësojë paraqitjen e faqes mbi baza periodike;

- Përmirësojë design-in e faqes për mënyrën e vendosjes së elementëve, imazheve etj. dhe zhvillimin e dizajneve të reja inovative apo sipas kërkesave të ALPEX;
- Optimizojë faqen për motorët e kërkimit të ëeb;
- Përmirësojë faqen drejt një integrimi më të madh me rrjetet sociale;
- Publikojë të dhënat e dërguara nga ALPEX brenda 30 minutave nga momenti i dërgimit.

Me qëllim ndjekjen dhe zbatimin e kontratës sipas të gjitha kushteve të saj, ALPEX ka caktuar një Administrator të kontratës, detyra e të cilit është sigurimi i përmbushjes i të gjitha detyrimeve përsa i përket faqes së internetit të ALPEX.

Përsa referuar më sipër, ALPEX garanton që pavarësisht detyrimit për të publikuar të dhënat brenda 1 (një) ore nga dalja e rezultateve, detyrim i parashikuar në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, Kontraktori referuar parashikimeve të kontratës detyrohet që të publikojë cdo të dhënë të dërguar nga ALPEX brenda një periudhe kohore prej 30 (tridhjetë) minutash, për të siguruar në këtë mënyrë informimin e Anëtarëve të Bursës dhe pjesëmarrësve të tregut në kohë.

Për më tepër, me miratimin nga ana Juaj të Procedurës së Komitetit të Bursës, cdo metodologji e nevojshme apo e kërkuar për implementim, do të konsultohet paraprakisht me anëtarët e këtij Komiteti, të cilët vijnë nga eksperiencia diverse në sektorin e energjisë elektrike brenda dhe jashtë vendit, duke siguruar në këtë mënyrë një proces transparent dhe informues përsa i përket aplikimin të metodologjive apo procedurave përkatëse, të cilat do të zbatohen në ALPEX.

Në rastin e miratimit nga ana Juaj të metodologjive të tjera, ALPEX do të garantojë publikimin e këtij informacioni në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë.

Përsa i përket pikës c) “Përshkrim i planeve për rastet emergjente dhe garancia që ky informacion është në dispozicion të gjithë pjesëmarrësve të tregut”, Ju informojmë si vijon.

Komunikimi apo dërgimi i informacionit nga ALPEX tek Anëtarët e Bursës ndahet në dy lloje.

1. Komunikimi apo dërgimi i informacionit të përditshëm, për tregtimin në kushte normale.
2. Komunikimi apo dërgimi i informacionit, në rastet përjashtimore nga tregtimi i zakonshëm:
 - a. Për rastet e emergjencave që lidhen me:
 - keqfunksionime të rrjetit;
 - keqfunksionime të sistemit ETSS;
 - keq funksionime të komunikimit të Sistemit të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) me Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS);
 - keq funksionime të komunikimit të Sistemit të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) me Sistemin e Skedulimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (MMS); apo

- keqfunksionime të sistemeve periferike.
 - b. Për rastet kur sipas parashikimeve të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Vendimeve Rregullatore përkatëse (Vendimi Nr. 139, datë 14.04.2023 Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të cmimit për tregun e ditës në avancë të Bordit të ERE), ALPEX duhet të kryejë një ankand të dytë.
- ❖ Gjatë kryerjes së tregtimit normal në Tregjet e ALPEX, komunikimi ndërmjet ALPEX dhe Anëtarëve të Bursës kryhet nëpërmjet komunikimit të Sistemit të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS), i cili u dërgon Anëtarëve informacionet përkatëse mbi rezultatet mbi volumet e tregtuara për cdo Njësi Kohore të Tregut (MTU) ku ata janë shpallur fitues. Përveç sa më sipër, të gjithë Anëtarët e Bursës që janë të aktivizuar në ETSS (dhe më specifikisht Agjentëve Tregtarë të Certifikuar), u dërgohet Cmimi Klerues për cdo Njësi Kohore të Tregut (MTU) për ditën përkatëse të livrimit.

Gjithashtu, për realizimin e punëve të përditshme, ALPEX, përveç lidhjes me Anëtarët e Bursës dhe Bankës për Shlyerje apo Agjentëve të Certifikuar të Klerimit, siguron edhe lidhjen me sistemin e menaxhimit të tregut të OST-ve, Shqipëri dhe Kosovë. Kjo lidhje është e siguar për shkëmbimin e informacioneve të përditshme siç parashikohet në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme apo Procedura e Tregtimit, të miratuara nga ana Juaj.

Edhe kjo lidhje është e realizuar si me sistemin kryesor të ALPEX ashtu edhe me sistemin në gatishmëri dhe kjo lidhje është e siguar nëpërmjet certifikatave të sigurisë të lëshuara nga të dy sistemet për rritjen e sigurisë dhe besueshmërisë ndërmjet palëve e për të eliminuar ndërhyrjet nga jashtë. Edhe nga ana e OST-ve janë marrë masat e duhura për garantimin e lidhjes në sistemin qendror edhe atë në gatishmëri. Për këtë qëllim janë realizuar shumë teste për të garantuar qëndrueshmërinë e lidhjeve dhe garantimin e sigurisë së tyre. Si lidhjet e sistemeve qendrore me njëra tjetrën ashtu edhe ato në gatishmëri përveç certifikatave të sigurisë, janë kryer duke realizuar lidhjen ndërmjet tyre site-to-site VPN high availability connectivity.

Pra, ALPEX, i garanton të gjithë përdoruesve të sistemeve të ALPEX, lidhje të qëndrueshme dhe të sigurtë, si dhe procedura alternative për mbështetjen e të gjithë Anëtarëve të Bursës apo përdoruesve të sistemeve të saj.

Ju bëjmë me dije se të dhënat e tregtimit apo klerimit ruhen në dy ambiente të ndryshme, në një llogaari në cloud (M-Office 365) dhe në storage e cila është e brendshme në ALPEX ku ka një redundancy për ruajtjen e të dhënave. Sa i përket ruajtjes fizike, platformat/sistemet e përdorura nga ALPEX, në të cilat kryhet tregtimi apo klerimi, janë sisteme, të dhënat e të cilave e kanë

qendrën/bazën në sistemet e veçanta të serverëve në ATHEX, në Athinë. Ruajtja e dyfishtë e të dhënave të tregtimit dhe klerimit, garanton sigurinë e ruajtjes së këtyre informacioneve për Anëtarët e Bursës, strukturat e ALPEX në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të monitorimit dhe raportimit, Entet Rregullatore të Energjisë për Republikën e Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe cdo institucion tjetër me funksione kontrolli në ALPEX.

- ❖ Gjatë rasteve përjashtimore nga tregtimi i zakonshëm, që lidhen me emergjencat mbi problemet teknike me sistemet, apo komunikimit ndërmjet tyre, të tilla si: keqfunksionime të rrjetit, keqfunksionime të sistemit ETSS, keq funksionime të komunikimit të Sistemit të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) me Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS), keq funksionime të komunikimit të Sistemit të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) me Sistemin e Skedulimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (MMS), apo keqfunksionime të sistemeve periferike dhe të tjera, për garantimin e operimit të sigurtë dhe pa probleme ALPEX-i ka parashikuar masat që do të ndërmerren dhe mekanizmat që do të përdoren, në seksionin F.2.1.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Termat e Përgjithshme, të cilat janë të miratuara nga ana Juaj.

Sipas këtyre parashikimeve, në këto kushte, është parashikuar që Sistemi Elektronik i Tregtimit në Çast ETSS (Electronic Trading Spot System) ka një tjetër sistem në gatishmëri (back-up), i cili në vetvete është sistem i pavarur elektronik dhe që do të aktivizohet në rast të mosfunksionimit të sistemit kryesor. Njëkohësisht, për garantimin e sigurtë dhe pa probleme të Tregtimit, në seksionin G.3, Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër, të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Tregtimit, e miratuar nga ana Juaj, është e parashikuar qartë se çfarë ndodh në rastet kur rrjeti nuk punon ose në rast të ndonjë problemi tjetër teknik ose funksional që pengon një Anëtar të Bursës të vendosi urdhërporosi në ETSS.

Gjithashtu, sa i përket garantimit të sigurisë dhe përputhshmërisë së ndërlidhjes së rrjetit të një Anëtari të Bursës me sistemin ETSS që përdor ALPEX janë parashikuar edhe detaje të tjera të hollësishme për të ndihmuar një Anëtar të Bursës për këtë qëllim. Këto të dhëna janë të parashikuara në seksionin G.1.2, Aksesi teknik, të Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Tregtimit, e miratuar nga ERE. Për çështje sigurie, ALPEX ju lejon akses për përdorim në sistemet e veta vetëm përdoruesve të autorizuar siç është parashikuar në seksionin F.2.3 të Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Termat e Përgjithshme, e miratuar nga ERE.

Për sa më sipër përmendur, procedura “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër”, është parashikuar dhe detajuar në Vendimin Teknik Nr. 3 – T “Procedurat e tregtimit emergjent në Tregjet e ALPEX”, objekti i të cilit është të përcaktojë mekanizmat dhe procedurat alternative të tregtimit në rast të keq funksionimit të Sistemit të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) ose emergjencave të tjera, me qëllim ruajtjen e funksionimit të duhur të Tregjeve të ALPEX-it dhe mbrojtjen e interesave të Anëtarëve të Bursës.

Në këtë vendim janë parashikuar veprimet që ndërmerren në rastet përjashtimore nga tregtimi i zakonshëm, Klerimi dhe Shlyerja ose emergjenca të tjera. Në rast të keq funksionimeve të rrjetit, keq funksionimeve të sistemit ETSS, keq funksionimeve të komunikimit të Sistemit të Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) me Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS), apo keq funksionimeve në sistemet periferike, ALPEX do të garantojë se:

- a. është zbuluar keq funksionimi dhe sistemi i menaxhimit për këtë problem do të aktivizohet;
- b. janë ndërmarrë veprime korrigjuese, dhe
- c. veprimet për zgjidhjen e keq funksionimit regjistrohen, duke informuar Anëtarët e Bursës me çdo mjet të përshtatshëm për problemin.

Procedura për mbështetjen e Tregtimit të Anëtarëve të Bursës parashikon se në rast të keq funksionimeve teknike të sistemeve të Anëtarëve të Bursës ose emergjencave të tjera, ALPEX-i u mundëson Anëtarëve të Bursës akses në ETSS nëpërmjet shërbimit “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër” të ALPEX siç përshkruhet në seksionin G.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Procedurat e Tregtimit.

Në këtë rast, Agjentët Tregtar të Certifikuar, të cilët tashmë janë të regjistruar në bazën e të dhënave të Anëtarëve të Bursës, mund të aplikojnë nëpërmjet një linje telefonike të regjistruar ose nëpërmjet Mjetit Elektronik të Emëruar (i cili do të sigurohet nga ALPEX-i) për ndihmën e ALPEX-it, për dorëzimin e një Urdhërporosie të re në ETSS, për modifikimin ose për anulimin e një urdhërporosie të dorëzuar, duke plotësuar të gjitha fushat e detyrueshme të Urdhërporosisë me ndihmën e ALPEX-it dhe në çdo rast 20 (njëzetë) minuta përpara Kohës përkatëse të Mbylljes së Portës. ALPEX-i do të kërkojë gjithashtu konfirmimin e Urdhërporosisë, nëpërmjet një formulari të përshtatshëm për regjistrimin e fushave të detyrueshme të Llojeve të Urdhërporosive, të ofruara nga ALPEX-i. Anëtari i Bursës nuk mund të pretendojë se Urdhërporositë janë dorëzuar në ETSS nëse nuk kanë marrë një konfirmim me shkrim nga ALPEX-i. Për më tepër, ALPEX nuk do të garantojë disponueshmërinë e numrit të mjaftueshëm të linjave telefonike. Shërbimi “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër” mund të përdoret vetëm për D-1 (orët e punës), në kuadër të Ditës së Livrimit.

Nëse paraqitet një numër i madh kërkesash, ALPEX-i do të dorëzojë Urdhërporositë duke u bazuar në parimin e përparësisë kohore, sipas vendimit rregullator të miratuar nga ana Juaj, përveç rasteve kur ka arsye për ruajtjen e funksionimit të mirë të tregut ose parandalimin e rreziqeve për Klerimin e Transaksioneve, që justifikojnë shmangien nga parimi i sipërpërmendur. Në çdo rast, plotësimi i kërkesës është parakusht për ofrimin e shërbimit.

Detajet teknike të regjistrimit të bisedave telefonike apo ruajtjes së shkëmbimit të të dhënave për shërbimin “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër”, paraqiten si më poshtë:

- a. ALPEX do të regjistrojë bisedat telefonike apo do të ruajë shkëmbimet e të dhënave që lidhen me dorëzimin e Urdhërporosive të reja në ETSS, modifikimin ose anulimin e një Urdhërporosie të dorëzuar, duke marrë të gjitha masat e nevojshme të sigurisë.
 - b. ALPEX do të verifikojë identitetin e telefonuesit përpara se të kryejë shërbimin “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër”.
 - c. Numri/at e telefonit për komunikimet me ALPEX-in do të postohen në faqen zyrtare të ueb-it të ALPEX www.alpex.al
 - d. Nuk lejohet kryerja e shërbimit “Tregtimi në Emër të Dikujt Tjetër” nga numra të tjerë të telefonit të Agjentëve Tregtar të Certifikuar, përveç atyre të dhëna në Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë.
- ❖ Referuar parashikimeve të paragrafit B.2.3 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Tregtimit, në rastet kur cmimi klerues që vjen nga zgjidhja e algoritmit të bashkimit të tregjeve të Ditës në Avancë, është i barabartë ose kalon kufirin minimal ose maksimal të cmimit të lejuar për tregun e Ditës në Avancë të përcaktuar (0€/MËh dhe 900€/MËh), për një ose më shumë njësi kohore tregu (MTU), për një ose më shumë zona ofertimi, ALPEX zhvillon një ankand të dytë.

Për këtë rast, komunikimi ndërmet ALPEX dhe Anëtarëve të Bursës kryhet në përputhje me parashikimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Procedura e Tregtimit si vijon.

Gjatë kryerjes së një Ankandi të dytë, ALPEX-i do të njoftojë Anëtarët e Bursës dhe rihapë Librin e Urdhërporosive për një periudhë të shkurtër kohe. Njoftimi i Anëtarëve të Bursës do të specifikojë:

- a. Kohën kur do të rihapet Libri i Urdhërporosisë; dhe
- b. Zonën e Ofertimit dhe Njësinë Kohore të Tregut që do të preket.

Rihapja e Librit të Urdhërporosive Lokale i jep mundësi Anëtarëve të Bursës të kenë mundësi të ndryshojnë ofertat e tyre për të përmirësuar rezultatin e zgjidhjes së Algoritmit të Bashkimit të Tregjeve të Ditës në Avancë, duke ndërmarrë veprimet e parashikuara në Procedurën e Tregtimit.

ALPEX-i duhet të bëjë një njoftim me anë të një Njoftimi për Tregu të dërguar me mjete elektronike për të gjithë Anëtarët. Për këtë qëllim me anë të procedurave të brendshme, ALPEX përdor një format Njoftimi për Tregun, i cili përmban të gjitha të dhënat e sipërpërmendura. (Ky format do Ju bashkëlidhet me këtë shkresë).

Për më tepër, Drejtoria e Operimit të Tregimit, këtë format të sipërcituar e njofton gjithashtu nëpërmjet adresës postare elektronike (e-mail) kundrejt të gjithë Agjentëve Tregtar të Certifikuar, të cilët janë të aktivizuar në ETSS.

Në rastin kur ALPEX do të operojë Bashkimin e Tregjeve, masat që ndërmerren janë:

- a. ALPEX-i do të njoftojë menjëherë Ofruesin e Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve dhe do të refuzojë Rezultatet Paraprake të Bashkimit të Tregjeve.
 - b. ALPEX-i do t'i dërgojë Ofruesit të Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve Librin i Urdhërporosisë Lokale të ndryshuar dhe do të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për ekzekutimin me sukses të Ankandit të Dytë.
 - c. Në rast se Ofruesi i Shërbimit të Bashkimit të Tregjeve nuk ka përfunduar Rezultatet e Ankandit të Dytë deri në periudhën e përcaktuar së Ndarjes së Plotë të Tregut ALPEX-i do të operojë në Tregun e Ditës në Avancë në gjendjen e Ndarjes së Plotë të Tregut.
- **germa “c”** Duhet të jetë me kosto eficiente në lidhje me bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe tregut brenda të njëjtës ditë dhe duhet të mbajë llogari të ndara për funksionet e Operatorit të Tregut të Bashkuar dhe veprimtaritë e tjera me qëllim parandalimin e ndërsubvencioneve.

➤ **Dokumentacioni i nevojshëm si provë për plotësimin e nenit 4.1.c:**

Rolin e Operatorit të Tregut të Bashkuar (Market Coupling Operator – MCO) për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike e realizon Ofruesi i Shërbimit që është Bursa e Energjisë në Greqi, Hellenic Energy Exchange - HEnEx S.A, sipas termave të referencës të Kontratës së nënshkruar për këtë qëllim, e cila është dërguar pranë Jush në aplikimin e parë.

Sa i përket kostove eficiente në lidhje me bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe tregut brenda të njëjtës ditë, nuk ka.

Për më tepër, bëjmë me dije se pjesa i përket këtyre kostove ALPEX nuk parashikon kosto të tilla, pasi të gjitha kostot për bashkimin e tregjeve janë të përfshira në Listën e Cmimeve të Kontratës së sipërpërmendur, të nënshkruar midis ALPEX dhe Ofruesit të Shërbimit.

- **germa “d”**. Duhet të ketë aktivitet të ndarë nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut

➤ **Dokumentacioni i nevojshëm si provë për plotësimin e nenit 4.1.d:**

Sipas rastit, aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

3. Deklaratë nëse aplikuesi është duke bashkëpunuar me palë të tjera dhe nëse po cfarë aktivitetesh po ndërmerr me këto palë;

4. Një përmbledhje e plotë e të gjitha insitucioneve në vartësi funksionale të pjesëmarrësve të tjerë të tregut;
5. Informacion në lidhje me përbërjen dhe identitetin e zotëruesve direkte dhe indirekte, palë të tjera të lidhura ligjrisht, kompanitë mëmë, dhe filialet e tyre;
6. Në rast se aksionerët, palët e tjera ligjore, kompanitë mëmë, ose filialet janë pjesëmarrës të tregut, duhet të shpjegohet sesi aplikuesi ka organizuar ndarjen e biznesit dhe eliminimin e konfliktit të interesit.

Sa i përket dokumenteve mbështetëse që vërtetojnë se ALPEX ka aktivitet të ndarë nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut dhe konkretikisht pikës 3, e cila parashikon se duhet paraqitur një deklaratë nëse aplikuesi (ALPEX) është duke bashkëpunuar me palë të tjera dhe nëse po cfarë aktivitetesh po ndërmerret me këto palë, Ju bëjmë me dije se:

1. Ndërmjet ALPEX sh.a (Autoritet Kontraktues) dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) "Hellenic Energy Exchange S.A.", "Enex Clearing House S.A." dhe "Hellenic Exchanges - Athens Stock Exchange S.A", (Ofruesi i Shërbimit) është nënshkruar kontrata me objekt "Platforma Elektronike e Tregtimit për Tregun e Ditës në Avancë dhe atë Brenda së njëjtës Ditë, Infrastruktura dhe Shërbimet e Kërkuara për Operimin e Tregut të Organizuar në Shqipëri dhe Kosovë", me Nr. 37 Prot., datë 10.02.2022, si dhe Amendimi i kësaj Kontrate me Nr. 58 Prot., datë 22.02.2023 (të cilat janë depozituar pranë Jush në aplikimin e parë).
2. Ndërmjet Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut sh.a (KOSTT) dhe Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sh.a – Dega Kosovë (ALPEX), është nënshkruar Marrëveshja për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve nga KOSTT sh.a tek ALPEX – Dega në Kosovë për organizimin e tregut të energjisë elektrike të një dite para, tregut ndër ditor dhe kalkulimet e barazimet përfundimtare, me Nr. 2540 Prot, datë 16.12.2022.
3. Ndërmjet ALPEX sh.a dhe OST sh.a është nënshkruar Marrëveshja Operacionale, me Nr. 1832 Prot. datë 31.03.2023 (OST sh.a) dhe Nr. 107 Prot. datë 31.03.2023 (ALPEX sh.a). Kjo Marrëveshje është depozituar pranë Jush në aplikimin e parë.

Përveç sa më sipër cituar, bashkëlidhur do të gjeni një Deklaratë mbi bashkëpunimin e ALPEX me palët e sipërcituara (Ofruesi i Shërbimit, OST, KOSTT).

Sa i përket dokumenteve mbështetëse që vërtetojnë se ALPEX ka aktivitet të ndarë nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut dhe konkretikisht pikës 4, e cila parashikon se duhet paraqitur një përmbledhje e plotë e të gjitha insitucioneve në vartësi funksionale të pjesëmarrësve të tjerë të tregut, bëjmë me dije se përse kuptuar nga ana jonë për përmbushjen e kësaj kërkesë, ALPEX nuk është në vartësinë funksionale të asnjë institucioni, si dhe nuk ka asnjë institucion nën vartësinë e tij funksionale. Përveç sa më sipër cituar, bashkëlidhur do të gjeni një Deklaratë mbi vartësinë institucionale të ALPEX.

Sa i përket dokumenteve mbështetëse që vërtetojnë se ALPEX ka aktivitet të ndarë nga pjesëmarrësit e tjerë të tregut dhe konkretisht pikës 5, e cila parashikon se duhet paraqitur informacion në lidhje me përbërjen dhe identitetin e zotëruesve direkt dhe indirekt, palë të tjera të lidhura ligjërisht, kompanitë mëmë dhe filialet e tyre dhe pikës 6, e cila parashikon se në rast se aksionerët, palët e tjera ligjore, kompanitë mëmë, ose filialet janë pjesëmarrës të tregut, duhet të shpjegohet sesi aplikuesi ka organizuar ndarjen e biznesit dhe eliminimin e konfliktit të interesit, Ju bëjmë me dije si vijon:

ALPEX sh.a është formuar si një shoqëri aksionare sipas Marrëveshjes së Aksionarëve për krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike më datë 05.10.2020, të lidhur ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit - OST sh.a, aksionar me 57,25% të kapitalit dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh.a, aksionar me 42,75% të kapitalit të ALPEX. ALPEX sh.a ka si organe drejtuese të shoqërisë Asamblenë e Përgjithshme dhe Këshillin Mbikëqyrës të shoqërisë, të cilët veprojnë në mënyrë të pavarur nga Drejtimi i brendshëm i shoqërisë. Mbledhja e aksionarëve të shoqërisë përfaqësohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila i miraton vendimet e saj me kuorimin e nevojshëm dhe me shumicë votash sipas parashikimeve të Legjislacionit në fuqi. Në Asamblenë e Përgjithshme të ALPEX aksionerët përfaqësohet respektivisht nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT sh.a dhe Administratori i OST sh.a.

Përsa i përket Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, ai është i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët caktohen nga Asambleja e Përgjithshme dhe miratohen nga aksionerët. Sipas parashikimeve të Marrëveshjes së aksionarëve, OST sh.a ka të drejtë të zgjedhë dhe propozojë 3 (tre) anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe KOSTT sh.a ka të drejtë të zgjedhë dhe propozojë 2 (dy) anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës.

Administratori i ALPEX sh.a emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës i ALPEX sh.a.

Drejtuksi i Degës propozohet nga Administratori i shoqërisë dhe emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, në përputhje me procedurën e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme për përzgjedhjen e Administratorit të Shoqërisë.

ALPEX sh.a nuk ka kompani mëmë apo filiale.

Aksionari i Shoqërisë OST sh.a është Anëtar i Bursës ALPEX që prej datës 31.03.2023 dhe i është nënshtruar procedurave të Anëtarësimit në Bursë sipas parashikimeve të Rregullave të ALPEX - Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat, si edhe Vendimeve Përkatëse Teknike të Tregtimit dhe Klerimit, të nevojshme për anëtarësimin në ALPEX. Këto procedura anëtarësimi janë zbatuar me përpikmëri nga ALPEX kundrejt të gjithë pjesëmarrësve të tregut, duke përfshirë këtu edhe shoqëritë e tjera publike. Në vijim, me lancimin e Tregut të Ditës në Avancë për zonën ofertuese të Kosovës dhe bashkimin e Tregjeve Shqipëri – Kosovë këto procedura do të ndërmerren edhe nga KOSTT sh.a, duke u trajtuar si Anëtar i Bursës në përputhje me parashikimet e dokumenteve të sipërpërmendura, pavarësisht cilësisë së tij si aksionar i ALPEX sh.a.

Përsa më sipër, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 317, datë 27/04/2016 “Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit

të energjisë elektrike” bëjmë me dije se OST sh.a ka në cilësinë e aksionarit të shoqërisë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. OST sh.a nuk ka kompani mëmë apo filiale (njësitë operative) të anëtarësuara apo që pritet të anëtarësohen në Bursë.

KOSTT sh.a ka në cilësinë e aksionarit të shoqërisë Republikën e Kosovës, sipas parashikimeve statutore. KOSTT sh.a nuk ka kompani mëmë apo filiale (njësitë operative) të anëtarësuara apo që pritet të anëtarësohen në Bursë.

Në kushtet kur OST sh.a është bërë anëtar i ALPEX që prej datës 31/03/2023 dhe në kushtet kur pritet që me lancimin e Tregut të Ditës në Avancë për zonën ofertuese të Kosovës dhe bashkimin e Tregjeve Shqipëri – Kosovë, anëtar i ALPEX të behët edhe KOSTT sh.a, bëjmë me dije se marrëdhënia si aksionar që kanë me ALPEX-in dhe marrëdhënia si anëtar i bursës në ALPEX janë dy procese të vecuara nga njëra tjetra.

Pavarësisht detyrave të kompanive, në cilësinë e aksionarëve përfaqësues në Asamblenë e Përgjithshme të ALPEX, bëjmë me dije se Asambleja merr vendime vetëm përsa i përket pjesës financiare dhe ligjore të shoqërisë, ndërkohë përsa i përket proceseve/veprime operationale, në funksion të përmbushjes së detyrave ligjore dhe statutore të ALPEX, ALPEX ushtron pavarësi të plotë në vendimmarrje.

- **germa “e”.** Nuk përdor tarifat e përcaktuara sipas Nenit 3 pika 8 për të financuar veprimtaritë e tregëtimit të ditës në avancë dhe atij brenda të njëjtës ditë tek një Palë tjetër, përveç palës nga e cila ka mbledhur/marrë tarifat.

➤ **Dokumentacioni i nevojshëm si provë për plotësimin e nenit 4.1.e:**

Aplikuesi pritet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Një përshkrim dhe shpjegim të qartë të proceseve të tij të llogaritjes për çdo njërin prej aktiviteteve ligjore monopol.

Përsa i përket përmbushjes së kësaj pike, Ju bëjmë me dije se sipas parashikimeve në Statutin e ALPEX, objekti i vetëm i veprimtarisë së ALPEX është si vijon:

1. Objekti i Shoqërisë është:

- a. Krijimi, menaxhimi dhe administrimi i tregut të organizuar të energjisë elektrike (në vijim referuar edhe si “Tregu”) nëpërmjet platformës së tregut, në bazë të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë;
- b. kompensimit financiar (clearing) mes pjesëmarrësve të tregut, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Sektorit të Energjisë Elektrike, Rregullat e Tregut të energjisë elektrike dhe Modelin e Tregut të energjisë elektrike, në fuqi.

- c. bashkimin e tregjeve (market coupling) të energjisë elektrike
2. Sa më sipër përfshin gjithashtu, por pa u kufizuar, aktivitetet e mëposhtme:
- a. zhvillimin e produkteve të tregut të energjisë elektrike;
 - b. planifikimin, zhvillimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e përpunimit elektronik të dhënave në lidhje me Tregun;
 - c. mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit në lidhje me produktet e energjisë elektrike në lidhje me Tregun;
 - d. përmbytjen e aktiviteve të kompensimit financiar (clearing&settlement)

Përsa më sipër shpjeguar, sic dhe parashikuar në Statutin e ALPEX, ALPEX nuk do të ushtrojë aktivitete të tjera të veprimtarisë dhe si rrjedhojë nuk është e nevojshme të mbajë llogari të ndara nga aktivitetet e tjera ushtrimore. Të gjitha aktivitetet që ALPEX ushtron janë të mirëpërcaktuara në statutin e ALPEX dhe ALPEX garanton se llogaritë për shërbimet e tregut të ditës në avancë dhe ato brenda së njëjtës ditë mbahen të ndara nga cdo shërbim apo aktivitet tjetër i ALPEX.

- **germa “f”.** Duhet të jetë në gjendje të garantojë trajtimin e të gjithë pjesëmarrësve të tregut në mënyrë jo diskriminuese.

➤ **Dokumentacioni i nevojshëm si provë për plotësimin e nenit 4.1.f:**

Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Një shpjegim të detajuar të procedurave për pjesëmarrësit e tregut të bashkuar dhe që do të përdorin shërbimet e aplikuesit të cilat nuk lejojnë diskriminimin e pjesëmarrësve të tregut;
2. Rregullat e tregut të cilat do të aplikohen për të gjithë pjesëmarrësit e tregut duhet të sigurojnë që nuk do të ketë diskriminim në treg;
3. Procedurat e brendshme duhet të përcaktohen me shkrim si dhe marrëveshjet funksionale, marrëveshjet kontraktore, dhe shërbimet për pjesëmarrësit e tregut duhet mos jenë diskriminuese.

Në lidhje me dokumentacionet mbështetëse që kërkohen nga ana Juaj në kërkesat e sipërpërmendura (1, 2, 3), bëjme me dije se për të mundur implementimin dhe zbatimin e përpiktë të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara nga ana Juaj, ALPEX ka hartuar dhe miratuar Vendimet Teknike përkatëse përsa i përket Tregtimit dhe Klerimit. Këto Vendime Teknike janë implementuar që nga periudha fillestare e lancimit të Tregut të Ditës në Avancë, me fillimin e procesit të anëtarësimeve në Bursë dhe zbatohen deri më tani, për 14 kompani në total (publike dhe private), si dhe për kompanitë e tjera të cilat janë në fazën e përmbytjes së procesit të anëtarësimit.

Sa më sipër, këto dokumente përcaktojnë në mënyrë të detajuar të gjitha hapat dhe dokumentet mbështetëse të cilat duhet të përmbyshen, brenda afateve të përcaktuara kohore, nga të gjithë pjesëmarrësit të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në tregjet e ALPEX-it, duke mos lënë hapsira përparësie apo preferenca kundrejt asnjë pjesëmarrësi potencial në Bursë.

Për më tej, Vendimi Teknik Nr. 1 -T “Procedura për Pranimin në Bursë të Anëtarit të Bursës, Dorëheqjes së tij dhe çështje të tjera në lidhje me Anëtarët e Bursës në Tregjet e ALPEX-it”, zbatohet rigorozisht për të gjithë anëtarët potencial në Bursë.

Në këtë vendim janë përcaktuar dokumentet e nevojshme dhe hapat që duhen përmbushur për të përmbyllur me sukses procesin e anëtarësimit në Bursë. Të gjitha parashikimet e dokumenteve të parashikuara në Vendimet Teknike përkatëse zbatohen në të njëjtën mënyrë për të gjithë Anëtarët e Bursës apo dhe pjesëmarrësit potencial dhe nuk parashikojnë dispozita preferenciale për asnjë prej këtyre Anëtarëve.

Përvec sa më sipër cituar, bashkëlidhur do të gjeni Vendimin Teknik Nr. 1 -T “Procedura për Pranimin në Bursë të Anëtarit të Bursës, Dorëheqjes së tij dhe çështje të tjera në lidhje me Anëtarët e Bursës në Tregjet e ALPEX-it”.

- **germa “g”.** Duhet të ketë rregulla dhe organizimin e përshtatshëm për mbikëqyrjen e tregut.

➤ **Dokumentacioni i nevojshëm si provë për plotësimin e nenit 4.1.g:**

Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetës të mëposhtëm:

1. Interpretim i detajuar i programeve të trajnimit duke përfshirë:

- a. Nese drejtuesit dhe punonjësit kanë ose do të kenë njohje të marrëveshjeve të mbikëqyrjes së tregut;
- b. Nëse drejtuesit dhe punonjësit janë ose do të jenë në dijeni për çështjet e mbikëqyrjessë tregut, psh. çështjet e Rregullores së Transparencës dhe Integritetit së Tregut të Energjisë Elektrike me Shumicë (REMIT Regulation on Wholesale EnergyMarket Integrity and Transparency);
- c. Nese drejtuesit dhe punonjësit janë në dijeni të përgjegjësive të tyre për të raportuar çdo çështje të mundshme gjatë mbikëqyrjes së tregut.

2. Interpretim të qartë dhe të detajuar si dhe shpjegim të skemave të monitorimit dhe proceseve që lidhen me:

- a. grumbullimin e informacionit;
- b. monitorimin e aktiviteteve të tregëtimit;
- c. identifikimin e rasteve të mundshme;
- d. vlerësimin dhe hetimin të rasteve të mundshme;
- e. vlerësimin e përshkallëzuar të çështjeve të brendshme të mundshme duke bashkëpunuar me autoritetet përkatëse;
- f. përcaktimin se kush nga aplikuesi do të mbajë përgjegjësinë kryesore për këto procese

dhe nëse do të krijohet një njësi e veçantë për këtë çështje.

Përsa i përket përmbushjes së detyrimit për rregullat dhe organizimin e përshtatshëm të ALPEX në lidhje me mbikëqyrjen e tregut, si dhe informacionit të dërguar pranë Jush me aplikimin për emërimin si NEMO të ALPEX, Ju bëjmë me dije për fazën në të cilën ndodhet përmbushja e këtij detyrimi.

Sic edhe kemi shpjeguar më sipër, vendimet e kësaj natyre organizative kërkojnë miratimin përkatës të Këshillit Mbikëqyrës dhe Asamblesë së Përgjithshme të ALPEX sh.a. Propozimi përpara i përket strukturës organizative dhe më konkretisht parashikimit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut, është dërguar pranë organeve vendimmarrëse të ALPEX.

Ky propozim është vendosur në rend dite të organeve për t'u trajtuar në mbledhjen e rradhës, e cila pritet të jetë brenda muajit Korrik 2023.

Në vijim të vendimmarrjes së organeve qeverisëse, ALPEX do Ju informojë menjëherë dhe do vendosë në dispozicionin Tuaj të gjitha dokumentet provuese dhe interpretimin shterues përpara i përket kërkesave të kësaj pike të Rregullores.

- **germa “h”.** Duhet të ketë marrëveshje të duhura të transparencës dhe konfidencialitetit me pjesëmarrësit e tregut dhe OST.

➤ **Dokumentacioni i nevojshëm si prove për plotësimin e nenit 4.1.h:**

2. Të paraqesë çdo marrëveshje ekzistuese që është në zbatim.

Përpara i përket detyrimit të përmbushjes së kësaj kërkesë, ALPEX aktualisht nuk ka në fuqi një marrëveshje për këtë qëllim të nënshkruar midis anëtarëve të Bursës dhe OST- së.

Me qëllim përmbushjen e këtij detyrimi, aktualisht ALPEX është në fazën e hartimit të një marrëveshje standarde e cila do të përdoret me qëllim transparencën në shkëmbimin e të dhënave si dhe detyrimet e konfidencialitetit për ruajtjen e integritetit të Tregjeve të ALPEX.

Për këtë qëllim, bashkëngjitur gjeni draftin paraprak të kësaj Marrëveshje standarde, e cila do të konsultohet me palët përkatëse.

Me finalizimin dhe nënshkrimin e Marrëveshjes me palët përkatëse, ALPEX do të paraqesë pranë Jush Marrëveshjen standarde të miratuar dhe informacionin mbi të gjitha marrëveshjet e nënshkruara midis ALPEX-it dhe Anëtarëve të Bursës, përfshirë OST-në.

- **germa “i”.** Duhet të jetë në gjendje të ofrojë shërbimet e nevojshme të likuidimit dhe të shlyerjes së detyrimeve.

➤ **Dokumentacioni i nevojshëm si provë për plotësimin e nenit 4.1.i:**

Aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetëse të mëposhtme:

2. *Përshkrim dhe shpjegim i qartë i proceseve për të vendosur se cilat garanci nevojiten për shlyerje (likuidim)*

Për të përmbushur këtë pikë sqarojmë se bazuar edhe në Procedurën e Klerimit dhe Shlyerjes, përgjegjës për klerimin e transaksioneve të Anëtarëve të Bursës janë Anëtarët e Përgjithshëm të Klerimit. Anëtar të Përgjithshëm Klerimi janë bankat e nivelit të dytë, të cilët gjithashtu janë përgjegjës për vendosjen e garancisë në emër të ALPEX.

Në lidhje me këtë pikë, ALPEX ka nënshkruar me Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit, Marrveshjen Kuadër për Klerim, në të cilën janë përcaktuar të gjitha detyrimet kontraktuale ndërmjet palëve si edhe si se procedohet në rastet e rritjes apo uljes së garancisë apo edhe se si do të përdoret kjo garanci por vetëm në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve.

Kjo marrëveshje ka vendosur disa parashikime të cilat janë detyruese për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit, si vijon:

- a) Një Anëtar i Përgjithshëm Klerimi ka të drejtë të klerojë Transaksionet e Anëtarëve të Bursës, si edhe Transaksionet e Jo-Anëtarëve të Klerimit.
- b) Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit do të ofrojë shërbime si Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit për Anëtarin e Bursës, në përputhje me Rregullat dhe Procedurat e Tregut të Energjisë Elektrike (Dokumenteve).
- c) Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit do të jetë përgjegjës për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të tij në përputhje me dispozitat e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. Këto përgjegjësi do të përfshijnë çdo veprim ose mosveprim nga ana e organeve të tij përfaqësuese, punonjësve dhe në veçanti personit që ata përdorin për të hyrë në Sistemin e Klerimit të Tregut të Energjisë (EMCS) me qëllim klerimin e Transaksioneve të përfunduara në Tregjet e ALPEX-it.
- d) Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit është në dijeni dhe do të përmbushë kërkesat për të siguruar fondet e nevojshme dhe të kërkuara, duke përfshirë kontributin fillestar dhe minimal në llogarinë e Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve, siç kërkohet dhe udhëzohet nga ALPEX-i me Vendimin Teknik nr. 3-C datë 20.03.2023, publikuar në www.alpex.al
- e) Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit është në dijeni dhe pranon që ALPEX-i do të hapë dhe mbajë llogari bankare për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit, të cilat do të përfshijë, por nuk kufizohet në (i) një Llogari Bankare për Shlyerje dhe (ii) një Llogari Bankare të Garancisë në Para në emër të ALPEX – [Anëtar i Përgjithshëm i Klerimit]. Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit është në dijeni dhe do të jetë në përputhje me kërkesat për të siguruar fondet e nevojshme dhe ato të kërkuara në Llogarinë Bankare për Shlyerje për qëllime të pagesës së çdo detyrimi ose marrjes së çdo pretendimi që rrjedh nga Transaksioni i Anëtarëve

të Bursës të kontraktuar nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit në Tregjet e ALPEX-it. Detajet përkatëse të Llogarisë Bankare të Garancisë në Para të hapur në përputhje me parashikimet e kësaj dispozite, do të përfshihen në Shtojcën B bashkangjitur kësaj Marrëveshjeje.

- f) Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit është në dijeni dhe duhet të përmbushë kërkesën për të depozituar fondet e nevojshme në një llogari bankare në emër të ALPEX – BURSA CASH COLL.GCM, e cila do të shërbejë si Llogari Bankare të Garancisë në Para, sipas parashikimeve të përcaktuara në Dokumente. Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit do të sigurojë fondet e nevojshme dhe të kërkuara në Llogarinë Bankare të Garancisë në Para me qëllim garantimin e detyrimeve financiare të të gjithë Anëtarëve të Bursës të kontraktuar nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit, që rrjedhin nga transaksionet e tyre në tregjet e ALPEX-it. Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit mund të depozitojë fonde vetëm në Llogarinë Bankare të Garancisë në Para. ALPEX-i nuk lejohet të përdorë shumat në Llogarinë Bankare të Garancisë në Para për detyrimet e palëve të treta, të tërheqë ose transferojë ndonjë shumë në para nga kjo Llogari Bankare e Garancisë në Para, përveç në rastin e (i) një Mungese, ose (ii) kur Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit i kërkon ALPEX-it për të pakësuar Garancinë në para, në përputhje me dispozitat e Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. Depozitimi i fondeve në Llogarinë Bankare të Garancisë në Para është një kusht që Anëtarët e Bursës të kontraktuar nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit të lejohen të tregtojnë në Tregjet e ALPEX-it.
- g) Për qëllimet e veprimeve të parashikuara, vetëm rasti i Mospërmbushjes së Detyrimeve do të krijojë të drejtën e ALPEX-it për të ekzekutuar LoG dhe/ose përdorimin e parave nga Llogaria Bankare e Garancisë në Para, dhe nëse është e nevojshme, më pas përdorimin e pjesës proporcionale përkatëse në Fondin e Mospërmbushjes së Detyrimeve, veprim i cili do të kufizohet në Mospërmbushjen e Detyrimeve të Shlyerjes në Para nga ana e Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit. Çdo kategori tjetër e Mospërmbushjes së Detyrimeve, siç parashikohet në përkufizimin e saj në Dokumente, nuk do të krijojë të drejtën e ALPEX-it për përdorimin e fondeve në Llogarinë Bankare të Garancisë në Para dhe/ose ekzekutimin e Letrës së Garancisë Bankare ose për të filluar një ekzekutim të Garancisë.
- h) Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit është në dijeni dhe do të veprojë në përputhje me kërkesat për të paraqitur një Letër Garanci Bankare në favor të ALPEX-it, në shumën, formën dhe mënyrën standarde të kërkuar nga ALPEX-i, siç përcaktohet në shtojcën II të Vendimit Teknik nr. 3-C datë 20/03/2023 për të garantuar detyrimet financiare ndaj ALPEX-it që rrjedhin nga Transaksionet e Anëtarëve të Bursës të kontraktuar nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit në Tregjet e ALPEX-it.
- i) Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes do të zbatohen për të gjitha Transaksionet dhe Mosmarrëveshjet siç përcaktohet në seksionin F.4 të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes ndërmjet ALPEX-it dhe Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit.

- j) Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit duhet të jetë në përputhje me kërkesat financiare përkatëse të përcaktuara nga ALPEX dhe të sigurojë margjinat e kërkuara sipas dispozitave të Dokumenteve, si një parakusht për pranueshmërinë e Anëtarit të Bursës për të tregtuar.
- k) Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit do të kryejë Klerimin e Transaksioneve nëpërmjet Llogarisë së Klerimit të Anëtarëve të Bursës për dhe në emër të Anëtarëve të Bursës. Në një rast të tillë, Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit lejohet të klerojë transaksionet e kryera nga një Anëtar i Bursës në tregjet e ALPEX në bazë të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.
- l) Përpara fillimit dhe/ose gjatë çdo Dite Tregtimi, Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit do të deklarojë në EMCS Anëtarët e Bursës, Transaksionet e të cilëve në Tregjet e ALPEX-it do të klerohen prej tij, si dhe Kufirin përkatës të Kreditit, siç përcaktohet në përputhje me Seksionin D.3.2.1 të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, i cili u caktohet këtyre Anëtarëve të Bursës në lidhje me Ditën përkatëse të Livrimit. Të gjitha veprimet në këtë paragraf do të konsiderohen si një deklaratë për përcaktimin e Klerimit të Transaksioneve përkatëse të Anëtarit të Bursës nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit dhe njëkohësisht një deklaratë ndërmarrjen e Klerimit nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit. Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit nuk lejohet të ndërmarrë Klerimin e ndonjë Transaksioni për të cilin nuk ka bërë deklaratën e sipërpërmendur.
- m) ALPEX mund të kufizojë aksesin e një Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit në shërbimet e Klerimit nëse e sheh të nevojshme për të kontrolluar rrezikun e tij, duke zbatuar, aty ku duhet, dispozitat përkatëse të Seksionit F.6 të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.
- n) ALPEX do të kryejë, të paktën një herë në vit, një rishikim gjithëpërfshirës të përputhshmërisë së Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit me kushtet dhe kriteret për pranimin e tij në përputhje me përcaktimet e dispozitave në fuqi dhe sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje dhe të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes. ALPEX, në bazë të Vendimit Teknik nr. 1-C datë 20/03/2023, do të specifikojë çdo çështje teknike apo procedurale dhe detaje të nevojshme në lidhje me shqyrtimin e sipërpërmendur. Për të ruajtur statusin e tij, Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit duhet të respektojë çdo rekomandim të dhënë nga ALPEX në këtë kuadër të këtij rishikimi.
- o) Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit do të veprojë në përputhje me të gjitha detyrimet e specifikuar në Seksionin C.3 të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.
- p) Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit pranon të paguajë çdo tarifë fikse, tarifë variabël, tarifë, kamatëvonesë ose çdo taksë të zbatueshme sipas ligjit në fuqi, sipas rastit, të cilat janë të zbatueshme për Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit siç parashikohet ose përcaktohet për shkak të dispozitave të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e përgjithshme dhe Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes, të miratuara në kohën e kësaj Marrëveshjeje.

- q) Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit merr përsipër që për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje do të angazhojë në Klerimin dhe Shlyerjen e Transaksioneve vetëm personel të trajnuar dhe të certifikuar siç duhet sipas kërkesave të Dokumenteve.
- r) Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit pranon që, për të patur akses në shërbimet e Klerimit, do të përmbushë dhe të jetë në përputhje me të gjitha kërkesat e legjislacionit të Shqipërisë, dispozitat e Dokumenteve, dhe me kërkesat tregtare shoqëruese dhe të gjitha detyrimet e tjera të lidhura siç specifikohen në Dokumentet dhe këtë Marrëveshje.
- s) Në rast të shkeljes së kësaj Marrëveshjeje dhe dispozitave të Dokumenteve, pala shkelëse do të jetë përgjegjëse për kompensimin e dëmeve të shkaktuara palës tjetër, në përputhje me dhe brenda kufizimeve të përcaktuara në dokumente.

Përsa më sipër shpjeguar, këto janë parashikimet e vendosura me Anëtarin e Përgjithshëm të Klerimit përsa i përket procesit të shlyerjes (likuidimit). Bëjmë me dije se Kjo Marrëveshje për shkak të detyrimit të konfidencialitetit të saj, nuk mund të dërgohet pranë Jush dhe si rrjedhojë më sipër kemi vendosur proceset e nevojshme për përmbushjen e kësaj pike.

3. *Vlerësim i riskut dhe analizë studimore e bërë për të treguar përballimin e riskut në vazhdim.*

ALPEX në Marrëveshjen Kuadër për Klerim ka parashikuar disa masa dhe hapa që do ndërmerren në rastet e riskut të mundshëm nga mos shlyerja e detyrimeve. Ky parashikim është i përcaktuar në Shtojcën A të Marrëveshjes, e cila është pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Disa nga parashikimet kryesore paraqiten si vijon:

ALPEX dhe Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit, bashkërisht bien dakord dhe ofrojnë termat dhe kushtet e mëposhtme për përdorimin e fondeve të dhëna nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit si garanci në para në Llogarinë e Garancisë në Para në emër të ALPEX-it, me detajet e mëposhtme:

Fondet sipas Llogarisë së Garancisë në Para janë fonde të Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit, të cilat do të shërbejnë si garanci në para për disa ose të gjithë Kufirin e Kreditit për secilin nga Anëtarët e Bursës të përfaqësuar nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit, në përputhje me dispozitat e Seksionit G.2.2. – G.2.3, dhe G.3 të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes dhe Vendimit Teknik nr. 3-C datë 20/03/2023.

Fondet në Llogarinë e Garancisë në Para, të depozituara nga Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit në përputhje me dispozitat e mësipërme, nuk do të përdoren nga ALPEX-i për detyrimet e palëve të treta, për të tërhequr ose transferuar ndonjë shumë nga kjo Llogari e Garancisë në Para, me përjashtim të rastit të (i) Një Mungese (Shortfall), ose (ii) kur Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit i

kërkon ALPEX-it të ulë Garancinë në Para, në përputhje me dispozitat e paragrafit G.2.3.2 të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.

Për qëllime të së drejtës së ALPEX për të ekzekutuar garancinë në përputhje me seksionin G.3.3, si dhe aktivizimin e Hapave për përdorimin e Fondit të Mospërmbushjes të Detyrimeve (Default Event), e vetmja ngjarje e Mospërmbushjes që do të krijojë të drejtën e ALPEX për të filluar këto veprime do të jetë në rast të mospërmbushjes së detyrimeve të Shlyerjes në Para. Çdo kategori tjetër e Mospërmbushjes, siç parashikohet në përkufizim, nuk do të shkaktojë ekzekutimin e Garancisë dhe përdorimin e pjesës proporcionale të Fondit të Mospërmbushjes së Detyrimeve.

Pas ngjarjes së Mospërmbushjes së Detyrimeve, siç përcaktohet më sipër, ALPEX-i do t'i dërgojë Anëtarit të Përgjithshëm të Klerimit një Njoftim për Mospërmbushjen e Detyrimeve, në përputhje me Seksionin F.2.4., në të cilën përcaktohet afati kohor për periudhën e korigjimit. Pas marrjes së Njoftimit për Mospërmbushje Detyrimesh, Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit do të verifikojë menjëherë nëse ngjarja e Mospërmbushjes ka ndodhur.

Pas verifikimit të ngjarjes së Mospërmbushjes së Detyrimeve, Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit do t'i sigurojë ALPEX-it çdo provë që ngjarja e Mospërmbushjes së Detyrimeve është ose do të korigjohet brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Mospërmbushjes së lëshuar nga ALPEX, rast në të cilin ALPEX-i nuk do të vijojë me kërkesën për ekzekutimin e Garancisë. Në të kundërt, Anëtari i Përgjithshëm i Klerimit, do të pajtohet menjëherë me ekzekutimin nga ALPEX-i të fondit në Llogarinë Bankare të Garancisë në Para, në përputhje me Seksionin G.3.3 të Procedurës së Klerimit dhe Shlyerjes.

Bëjmë me dije se me parashikimet e mësipërme është garantuar edhe përballimi i riskut në vazhdim përse i përket shërbimit të likuidimit dhe shlyerjes.

- 5. Përshkrim i qartë dhe shpjegimin e marrëveshjeve kontraktuale të nevojshme për të siguruar proceset e shlyerjes dhe likuidimit, përfshirë NEMO dhe OST e tjera dhe konfirmimin për marrëveshjet e operimit dhe ato kontraktuale të cilat lejojnë ose do të mundësojnë NEMO dhe OST e tjera që të funksionojnë në tregun e bashkuar të ditës në avancë dhe/ose atë brenda të njëjtës ditë.*

Përse i përket përmbushjes së kësaj pike, Ju informojmë se ALPEX ka aplikuar pranë Jush për tu përcaktuar si Operatori i emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për zonën e ofertuese të Shqipërisë dhe njëkohësisht ka paraqitur aplikimin pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRë) për tu emëruar si Operatori i emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për zonën e ofertuese të Kosovës. Në këto kushte, ALPEX me miratimin nga ana e Rregullatorëve, synon të emërohet si NEMO për të dyja zonat e ofertimit Shqipëri dhe Kosovë.

Referuar sa më sipër, si dhe referuar informacionit dhe dokumenteve të dërguara me aplikimin e ALPEX për përcaktimin si NEMO, më poshtë do të gjeni informacion mbi fazën aktuale të Marrëveshjeve.

1. Marrëveshja midis OST, KOSTT dhe ALPEX, ndodhet në fazën e hartimit të saj dhe ne sigurojmë që kjo marrëveshje do të finalizohet dhe nënshkruhet midis palëve përpara lancimit të Tregut të Ditës në Avancë për zonën ofertuese të Kosovës, e cila përkon edhe me bashkimin e Tregjeve midis Shqipërisë dhe Kosovës. Kjo Marrëveshje do të zbatohet edhe për bashkimin e Tregjeve Brenda së Njëjtës Ditë, në momentin e lancimit të tyre.
2. Marrëveshja midis OST-ALPEX dhe KOSTT-ALPEX për të ardhurat nga kongjestioni (congestion income), ndodhet në fazën e hartimit të saj.

Pavarësisht se ALPEX nuk është përcaktuar si NEMO akoma, për asnjë nga zonat e ofertimit, ka nisur puna në bashkëpunim me SEE CAO për hartimin e Marrëveshjes (Shadow Allocation Rules Agreement) midis palëve SEE CAO, OST, KOSTT dhe ALPEX. Kjo Marrëveshje është drejt finalizimit të saj dhe ALPEX siguron se ajo do të nënshkruhet menjëherë pasi ALPEX të emërohet si NEMO.

- **germa “j” dhe pika 4.2** Duhet të jetë në gjendje të vendosë sistemet dhe rregullat e nevojshme të komunikimit për t’u koordinuar me OST.

➤ **Dokumentacioni i nevojshëm si prove për plotësimin e nenit 4.1.j dhe pikës 4.2**

Sipas rastit, aplikuesi duhet të paraqesë dokumentat mbështetëse të mëposhtme:

2. Përshkrim dhe shpjegim i marrëveshjeve për rastet emergjente dhe planifikimi i menaxhimit të riskut.
3. Dokumentin e OST përkatëse ku konfirmohet pranimi i përshkrimit dhe shpjegimit të kërkuar më sipër dhe konfirmimi i OST që kjo mënyrë, softëare dhe hardëare janë të pranueshme për OST.

Nga sa kërkuar më sipër në pikën 2 dhe pikën 3, ndërmjet ALPEX, OST dhe Ofruesit të Shërbimit palët kanë reflektuar në një dokument të rene dakord të emërtuar ALPEX ETSS/EMCS – TSO Interfaces, lidhur me të gjitha mënyrat e komunikimit të Platformave ETSS/EMCS me Platformën e OST-së.

Në këtë dokument janë shënuar të gjitha oraret, mesazhet të cilat janë përdorur dhe janë ende në përdorim. Në këtë dokument janë parashikuar rastet e komunikimit back-up nëpërmjet transferimit manual të informacionit në një adresë të vecantë email-i drejt ALPEX-it.

Email që përdor ALPEX për komunikim me OST është si më poshtë:

- marketoperations@alpex.al

Email që përdoret nga OST për komunikim me ALPEX:

- scheduling@ost-mms.al

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi të hapur për çdo sqarim shtesë.

Me respekt,

ADMINISTRATOR I ALPEX SH.A.

Sokol Dishnica

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR, DREJTORIA E OPERIMIT TË TREGUT**

Bledi Lame



The stamp contains the ALPEX logo and the text: "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike", "ALPEX", "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike", and "NUIS M022230068".